

GAZETA SHQIPTARE



Kryeredaktor: Erl MURATI
Zv/kryeredaktore - Rezarta DELISULA
Tel:(04)2359-104, Fax:(04) 2359-116 E-mail:gazetashqiptare@hotmail.com



Viti XXIV - Nr. 7451 E diel 25 Shkurt 2018 Çmimi, 50 lekë (1.5 euro)

Opinion i Ditës

Nga BEN ANDONI

Qeveria e kryeministrit Edi Rama po mbush vitin e saj të pestë në krye të Ekzekutivit shqiptar. Veçoria që e dallon nga mandati i ish-qeverisë "Berisha" është ...
Vijon në faqen 21

Pse e majta shqiptare nuk qeveris dot si e majtë?!



Opinion i Ditës

Nga GENTI KRUIJA

Shqiptarët myslimanë patën një rol të padiskutueshëm dhe vendimtar në formimin e shtetit shqiptar. Parime të tilla si besa, mikpritja, bujaria, harmonia ...
Vijon në faqen 22

95 vjet nga themelimi i Komunitetit Mysliman të Shqipërisë



Tubimi para ambasadës greke në Tiranë

Çamët në protestë, Idrizi: Atdheu nuk negociohet, Athina të kërkojë falje

Kreu i PDIU: Përmendore për shqiptarët e vrarë në Çamëri dhe një varrezë dinjitoze

Nga DARINA TANUSHI

PDIU dhe shoqata "Çamëria" protestuan dje para ambasadës greke në Tiranë në lidhje me marrëveshjen që po diskutohet me palën drekte, duke kërkuar më shumë transparencë nga qeveria shqiptare. Kryetari i PDIU-së...

Në faqen 3

DEKLARIMI/ ÇFARË PASURISH KANE USHTARAKET E EMERUAR NGA EDI RAMA

PRONAT DHE LLOGARITE E PREFEKTEVE TE RINJ

Prefektja e Tiranës legalizoi ndërtim shtesë, ai i Kukësit pa makinë dhe pa llogari bankare. Prefekti i Fierit, të ardhura nga prodhimet bujqësore



(Në foto) Kryeministri Edi Rama gjatë prezantimit të 12 prefekteve

TAKIM ME METEN E RAMEN

Negotiatat me BE, kreu i Komisionit European, Juncker sot viziton Tiranën

Në faqen 2

ISH-KRYEPROKURORI

Ndërprerja e vetingut për Llallën, ONM: Ja pse nuk e apelojmë

Në faqen 5

PRANGA SHOFERIT

Aksidenti në rrugën Durrës-Kavajë, vdesin nusja e vjehri

Në faqen 9

RROGOZHINE

Akuzat për tjetërsim prone, kryebashkiaku: Jam i pafajshëm

Në faqen 12

LISTA E PRONAREVE



ATP: 1500 dosjet e vitit '97, vlerësimi financiar për çdo pronë që përfiton

Në faqen 10-11



Nga prof. Gazmend Shpuza/ "Bashkimi i Shqipërisë", i kompozuar nga Gjon Kanale

"Kanga e miletit", ose himni i vërtetë shqiptar

Në brendësi: Kristo Frashëri për Shmidin, Leka Ndoja, Ndue Dedaj

Nga GAZMEND SHPUZA

Pra katër vjetësh pata shkruar për këtë temë. Megjithatë, ende pak kush e din nëse ka ekzistuar një himn i Lidhjes së Prizrenit, cili është ai, kush janë autorët e tij dhe ca më pak njihet historia e ekze-



kutimit të tij me pengime të tejskashme gjatë këtyre afro 140 viteve që nga koha e krijimit. Është harruar, ka mbetur pothuajse i panjohur. E pabesueshme! Himni lindi në vitet e lavdishme 1878-1881. Megjithëse as katër vjet, ato ...

Suplement

PAKTI DETAR REAGIMET

Ministri grek u përgjigjet kritikëve të tij: Ka ende një proces institucional

Kotzias: Pakti detar me Shqipërinë detajohet pas firmës së Ilir Metës

"Ata që flasin për humbje e kanë vetëm në imagjinatë"

Ministri i Jashtëm grek, Nikos Kotzias bëri të qartë dje gjatë një interviste për televizionin grek 'ERT' se marrëveshja detare me Shqipërinë do të detajohet pasi Ministria e Jashtme e Shqipërisë të marrë autorizimin nga Presidenti i Republikës. Ministri grek i është përgjigjur edhe ish-kolegës së tij, Dora Bakojanis, e cila dy ditë më parë tha se do të thërrasë në interpelancë urgjente ministrin grek, Nikos Kotzias për marrëveshjen me Shqipërinë. Kotzias u shpreh në këtë intervistë se po akuzohet për një marrëveshje, që nuk ka përfunduar dhe nuk e ka parë askush. "Dhe përderisa ka ende një proces institucional në Shqipëri, unë po akuzohem për përmbajtjen e kësaj marrëveshjeje, që ne do e negociojmë me detaje pas lejes së Presidentit të Shqipërisë. Sigurisht që ne kemi diskutuar tashmë dhe ajo që po flasin për humbjen është në imagjinatën dhe shpresën për të gjetur një shkak për të akuzuar politikën e jashtme dhe jo realitetin. Por kjo është tipike. Mendoj se ka njerëz që nuk e kanë idenë e politikës së jashtme dhe si negociohet", u shpreh Kotzias, duke iu dhënë përgjigje të gjithë kritikëve në vendin e tij, që e akuzojnë se ka nënshkruar me palën shqiptare për humbje territori dhe miljesh.

Kotzias: Do të thosha që është një periudhë që e bën politiken e jashtme interesante sërish, edhe pse shqërohemi nga shtrembërime dhe lajme të rreme.

Gazetari: Ç'doni të thoni me këtë? Lajme të rreme...

Kotzias: Kam lexuar disa fakte inekzistente, për të cilat akuzohem...

Gazetari: Si për shembull?

Kotzias: Që u kam dorëzuar gjithë Jonin shqiptarëve...

Gazetari: Ah, a ia dorëzuat?

Kotzias: ... për zonën gri, thonë Demokracia e Re. Për një marrëveshje që nuk ka përfunduar dhe nuk e keni parë. Nga ana tjetër, ata më akuzojnë se nuk janë në dijeni të asaj që po ndodh në këtë proces dhe nga ana tjetër më akuzojnë për përmbajtjen e këtij procesi. Shpresoj që në një moment të zgjedhin vërtetë se për çfarë duan të më akuzojnë.

Gazetari: Ta bëjmë të qartë për botën që na dëgjon se po flisni për marrëveshjen me Shqipërinë, apo jo?

Kotzias: Po. Siç e dini dhe veçanërisht për çështjen e



Ministri i Jashtëm grek, Nikos Kotzias

DORA BAKOJANIS

Ish-ministria e Jashtme greke, Dora Bakojanis akuzoi qeverinë greke se po negocion në fshehtësi me Shqipërinë rishikimin e marrëveshjes për detin. Ajo ka kërkuar interpelancë me ministrin e Jashtëm, Nikos Kotzias, të cilit i kërkon të qartësojë se cilat pjesë të marrëveshjes po rishikohen.



Kryeministri Edi Rama dhe presidenti i KE-së, Jean Claude Juncker

Historiani: I prirur të them se presidenti ka të drejtë

Përplasja Bushati-Meta për plotfuqishmërinë, Xhufi: E tepërt, ngërçi do zgjidhet shpejt

Historiani dhe diplomati i njohur, Pëllumb Xhufi u shpreh dje se diskutimet mes Presidentit dhe Ministrisë së Jashtme për negociatat me Greqinë do të ishte e udhës të bëheshin në mënyrë informale dhe jo në sytë e publikut. Gjatë një interviste në emisionin "Kjo Javë" në "News 24", Xhufi u shpreh: "Është një gjë që mund të diskutohet me Presidencën dhe Ministrinë së Jashtme. Të dyja palët thonë se jemi në rregull me ligjin. Mendoj se është një përballje që do ishte dashur të zgjidhej përmes juristëve dhe jo përballë kamerave. Në të kundërt nuk do të kish të mungesë transparence, pasi një marrëveshje e tillë është e vështirë dhe komplekse. Është e vështirë që të bëhet



Historiani Pëllumb Xhufi

një marrëveshje e kësaj natyre, kësaj herë e drejtë, pasi e para rezultoi ndryshe. Edhe takimi i Metës me ish-presidentët besoj se duhet të ishte informal dhe nuk mendoj se duhet të publikohej", tha ai. Sa i takon qëndrimin të presiden-

tit, Xhufi u shpreh: "Nuk mund ta gjykoj Presidentin Meta dhe jam i prirur të them se ai ka të drejtë. Ajo që nuk më pëlqen në këtë histori është fakti që del një përplasje institucionale. Në kushte të tilla kur institucionet tona kanë shumë probleme, kur politika është në shënjestër të opinionit publik, një përplasje e tillë është e tepërt. Duke njohur natyrën e Presidentit Meta, do të doja ta kishte evituar dhe të procedonte në mënyrë informale. Nëse këto kontradikta do të vijojnë, atëherë nuk do mund të fshiheshin më. Por jam i bindur që do të kapërcehet ky ngërç dhe ne të gjithë do të shprehim zhgënjim pas duhet të ndodhte diçka e tillë", u shpreh Xhufi.

PËRPLASJA

Ministri i Jashtëm, Ditmir Bushati i kërkoj Presidentit të Republikës plotfuqishmërinë për të negociuar marrëveshjen për paktin detar me palën greke. Por, kërkesa e Bushatit u vlerësua e paplotë nga Meta, i cili i ka kërkuar tashmë edhe emrat e negociatorëve dhe detaje të marrëveshjes para se të firmosë autorizimin.



Delegacioni i lartë evropian, tur në Ballkan deri më 1 mars

Negociatat me BE, presidenti i KE-së Juncker, sot në Tiranë, takon Ramën

Presidenti i Komisionit Evropian, Jean Claude Juncker mbërrin sot pasdite në Tiranë për një vizitë zyrtare, në kuadër të një turneu në Ballkan. Sipas njoftimit për shtyp nga Krye-ministria, Juncker do të mbërrijë në krye të një delegacioni, në orën 17:30 në Tiranë, ku do të pritët me një ceremoni ushtarake nga kryeministri Edi Rama. Ndërsa në orën 19:15, Rama dhe Juncker do të zhvillojnë një konferencë të përbashkët për shtyp, ku sigurisht pritet të shpallet edhe mendimi i presidentit të KE-së për hapjen e negociatave me Bashkimin Evropian, për të cilin në fakt vendimin e marrin vendet anëtare. Ditën e hënë, presidenti i KE-së do të takojë edhe presidentin Ilir Meta. Kreu i Komisionit Evropian, Juncker; shefja për Politikë të Jashtme dhe Siguri e BE-së, Federica Mogherini dhe komisioneri për Zgjerim, Johannes Hahn do të vizitojnë vendet e Ballkanit, në kuadër të një turneu të tyre në Ballkan. Ata do të vizitojnë fillimisht Maqedoninë, pastaj Shqipërinë, Serbinë, Malin e Zi, Bosnje dhe Hercegovinën dhe ndalesa e fundit e tyre do të jetë në Bullgari. Ky turne që nis nga 25 shkurti dhe përfundon më 1 mars, bëhet për të prezantuar strategjinë e BE-së për rajonin e Ballkanit Perëndimor. Ndërsa e fundit është Sofja, ku kryeministri bullgar, Bojko Borisov, do të shtrojë një darkë zyrtare ku do të presë edhe gjashtë kryeministrit e vendeve të Ballkanit Perëndimor. Kryeministri shqiptar, Edi Rama u takua me presidentin e Komisionit Evropian, Jean-Claude Juncker në dhjetor të vitit të shkuar.



JOHANNES HAHN

"Do të jenë shtetet anëtare që do të vendosin se kur do të nisim bisedimet e anëtarësimit. Franca, por para së gjithash Gjermania, kanë rezerva të mëdha në rastin e Shqipërisë. Shqiptarët natyrisht që vuajnë nën një imazh të caktuar", deklaroi pak ditë më parë komisioneri Hahn.

Tubimi para ambasadës greke në Tiranë, kreu i PDIU: Nuk duam ndryshim kufijsh

Çamët në protestë, Idrizi: Deti, toka, atdheu ynë nuk negociohen

"Haram nëse rruga për në BE shihet nga Athina"

Darina Tanushi

PDIU dhe shoqata "Çamëria" protestu an dje para ambasadës greke në Tiranë në lidhje me marrëveshjen që po diskutohet me palën dreke, duke kërkuar më shumë transparencë nga qeveria shqiptare. Kryetari i PDIU-së, Shpëtim Idrizi tha para protestuesve: "Ne jemi këtu të bindur që deti, toka, atdheu, varrezat nuk janë të pushtetarëve, por amanet nga Zoti që ne duhet t'ua transmetojmë brezave. Ne nuk mund të negociojmë integritetin dhe sovranitetin e Shqipërisë. Vetëm mundet ta ruajmë me dinjitet".

Në lidhje me çështjen çame, kreu i PDIU ka theksuar se ky komunitet nuk është duke kërkuar prona e përfitimë, por dinjitet. "Ne nuk kërkojmë prona, ne kërkojmë atdheun dhe atdheu ynë është Çamëria. Kërkojmë që Çamëria, shqiptarët që jetojnë atje, arvanitasit të shpallen minoriteti etnik shqiptar në vatrat e tyre", u shpreh Idrizi. Ai shtoi se nuk kërkojnë ndryshim kufijsh, por falje për çamët e vrarë. "Duhej të ngrihej përmendorja për shqiptarët e vrarë në Çamëri dhe një varrezë dinjitoze për ta", tha Idrizi.

"Deti, toka, varrezat Çamëria nuk negociohen, por zgjidhen me dinjitet. Haram u qoftë shqiptarëve nëse e shohin Europën e Perëndimin nga Athina! Çamëria është makthi i kokave të shtrembra të Greqisë, që ndërsa flasin për prindërit tanë, si bashkëpunëtorë kanë Agimin e Artë, nazistët e tyre në parlamentin e Greqisë. U bëj thirrje Edi Ramës, Ditmir Bushatit, Ilir Metës, zotit Basha. Unë e di që nuk i keni dhënë dot prosperitet e zhvillim ekonomik shqiptarëve, por të paktën e keni për detyrë t'i jepni dinjitet", tha Idrizi.

"Deti toka, varrezat nuk janë të pushtetarëve por amanet nga Zoti që ne duhet transmetohen. Deti toka, varrezat Çamëria nuk negociohen por zgjidhen me dinjitet. Haram u qoftë shqiptarëve nëse e shohin Europën e Perëndimin nga Athina! Çamëria është makthi i kokave të shtrembura



Kryetari i PDIU-së, Shpëtim Idrizi gjatë protestës së djeshme

SHPETIM IDRIZI

"Ne jemi këtu të bindur që deti, toka, atdheu, varrezat nuk janë të pushtetarëve, por amanet nga Zoti që ne duhet t'ua transmetojmë brezave. Ne nuk mund të negociojmë integritetin dhe sovranitetin e Shqipërisë", tha kreu i PDIU.

të Greqisë që ndërsa flasin për prindërit tanë si bashkëpunëtorë e kanë Agimin e Artë, nazistët e tyre në parlamentin e Greqisë", deklaroi ai. Me pankartat

"Çamëria është Shqipëri", çamët kërkuar transparencë për procesin e negociatave. Tahir Nuredini, president nderi i çamëve, tha se nuk mund ta marrin vesh

çamët nga Ministri grek që s'është diskutuar asgjë për ta dhe se Ministria e Jashtme nuk mund të jetë aq e mbyllur në lidhje me këtë çështje të rëndësishme.

Ministri i Jashtëm: Gjeografikisht jemi pjesë e Evropës

Bushati: Shqipëria e rajoni presin anëtarësimin në BE brenda 10 viteve

Ministri për Evropën e Punët e Jashtme, Ditmir Bushati deklaroi se është realitet që "Shqipëria dhe vendet e tjera të rajonit të bashkohen me BE-në brenda një 10- vjeçari". Ai paralajmëroi në të njëjtën kohë se në BE diskutohet gjithnjë vetëm kostoja e Zgjerimit të Bashkimit me vendet e Ballkanit Perëndimor. "Nuk kam dëgjuar që të flasë dikush për koston e moszbatimit". Në sfond qëndrojnë rezervat e disa shteteve të BE-së kundër pranimit të Serbisë, Malit të Zi, Maqedonisë, Shqipërisë, Kosovës dhe Bosnjës dhe Hercegovinës. "Por, ne po flasin këtu për një rajon që është gjeografikisht qartësisht pjesë e Evropës", tha Bushati për "Reuters". Në fillim të shkurtit, Komisioni i BE-së u hapur gjashtë vende të Ballkanit Perëndimor mundësinë për t'u bashkuar me BE-në, deri në vitin 2025, por në të njëjtën kohë ka bërë thirrje për përpjekje më të mëdha për reforma. Bisedimet janë hapur tashmë me Serbinë



dhe Malin e Zi. Sipas informacioneve të Bushatit, Shqipëria qëndron pak para fillimit të çeljes së bisedimeve të pranimit. Bushati i bëri thirrje Gjermanisë dhe BE-së që të rrisë angazhimin e saj në rajon. Gjermania ka iniciuar të ashtuquajturin Proces të Berlinit për rajonin, i cili synon të nxisë bashkëpunimin midis vendeve të Ballkanit Perëndimor nëpërmjet organizimit të samiteve të rregullta. "Por unë do të doja të shihja veprime më kon-

krete", tha ai. Nevojiten investime ndërkufitare në infrastrukturën e shumicës së vendeve të vogla. "Kjo do t'i lidhë vendet e Ballkanit Perëndimor me njëri-tjetrin, por edhe me BE". Bushati nuk pret që të gjashtë vendet e Ballkanit Perëndimor të mund të bashkohen në BE në të njëjtën kohë. Ai u referohet ende mosmarrëveshjeve mes të vendeve të veçanta, kryesisht ndërmjet ish-republikave jugosllave.



Vasili: Ta refuzojmë Ramën, minoi orientimin strategjik të vendit, BE-SHBA

Kreu i grupit parlamentar të LSI-së akuzoi dje kryeministrin Rama se po punon kundër interesave europiane dhe proamerikane të qytetarëve shqiptarë. "Orientimi strategjik i Shqipërisë drejt SHBA-BE i trondituri thellë, shqiptarët do ta refuzojnë me çdo mjet", u shpreh dje në një status në rrjetin social "Facebook", Vasili. "Për shkak të një kryeministri peng interesash të errëta, Shqipëria sot gjendet në çorientimin më të rëndë dhe të qëllimshëm strategjik dhe kombëtar si asnjë herë në këto 27 vite pluralizëm. Orientimi strategjik madhor drejt SHBA-ve është sot jo vetëm i dyzuar, por edhe i shantazhuar. Realitete ekstraamerikane të lvera me bojën e interesave ekonomike të zymta po u vihen në tavolinë shqiptarëve si zgjidhje më të ëmbla dhe më të këndshme se sa sprova e demokracisë së fortë, parimore dhe të pagonciueshme amerikane, e cila e shëndosh Shqipërinë dhe e bën atë një realitet të qëndrueshëm politik-social", u shpreh Vasili. "Çdo kërkesë për vendosjen e shtetit ligjor nga SHBA dhe BE po shantazhohet nga kryeministri dhe ata që e ndjekin pas me kërcënimin shumë të rrezikshëm se 'do shkojmë andej nga na japin para', pavarësisht erës shpesh të qelbur të tyre, që natyrisht nuk janë as dollarë dhe as euro, por para të tjera gjithfarësh", u shpreh kreu i grupit parlamentar të LSI-së. Sipas tij, "shqiptarët janë shumë të qartë, ata kanë vetëm një bosh strategjik, që kalon nga SHBA dhe BE dhe tek vlerat fundamentale që inspirohen në Uashington e Bruksel dhe jo tek përkthimet e shtrembëruara lokale. Ky kryeministër që sot rastësisht qeveris vendin dhe që e minon këtë orientim strategjik do të refuzohet me forcë dhe me çdo çmim edhe nga shqiptari më i fundit".

SITUATA POLITIKE REAGIMET

Kryeministri paralajmëron punonjësit e institucioneve: Garanti cilësi

Shërbimet publike, Rama në Berat: Asnjë tolerancë për administratën

"Ndhim sociale, s'ka para për parazitët"

Darina Tanushi

Kryeministri Edi Rama lajmëroi dje nga Berat punonjësit e administratës publike se nuk do të tolerohen nëse nuk u kthejnë shërbimet qytetarëve. Në një bashkëbisedim me administratën vendore të Beratit, Rama tha: "Nuk do të ketë asnjë tolerancë për asnjë drejtues që nuk garanton këtë cilësi të kërkuar shërbimi dhe plotësisht të mundur, falë nga njëra anë e sistemit elektronik që duhet të përdoret gjerësisht nga administrata, nëse qytetarët nuk e përdorin drejtpërdrejtë nga shtëpia për pamundësi, apo për mungesë informacioni, qoftë për atë që thashë në fillim, garantimin e të gjithë dosjes për qytetarin nga vetë zyra, zyrë më zyrë". Sipas tij, "nuk duhet të jetë qytetari që të shkojë zyrë më zyrë, por duhet të jetë vetë zyra që duhet t'i japë qytetarit një dokument të kërkuar e që duhet të garantojë që e gjithë dosja të plotësohet brenda-



Kryeministri Edi Rama

përbrenda sistemit të administratës shtetërore". Ai foli edhe për reformën e ujit, për të cilën kërkoi bashkëpunim mes strukturave vendore, policisë dhe Ministrisë së Infrastrukturasë. Ai u kujtoi qytetarëve se, "furnizimi me ujë përmes lidhjes së paligjshme përbën vepër penale". Sa i përket ndihmës sociale, për të cilën ka marrë mjaft akuza e kritika këto ditë, Rama tha: "Ndhim ekonomike, siç e thotë qartësisht edhe

strategjia globale, por edhe strategjia dhe reforma specifike e draftuar nga ekspertët e Bankës Botërore në bashkëpunim me ne, adreson varfërinë e thellë, nuk adreson varfërinë që vjen nga pasiviteti, nga mungesa e vullnetit dhe dëshirës për të punuar". Rama solli raste të atyre që kanë marrë ndihmë ekonomike ndërsa kanë vllë e pronë. "Për parazitët, ne nuk kemi mundësi të shpenzojmë paratë e marrë nga taksat", tha Rama.

FERMERËT

Në lidhje me subvencionet për fermerët, Rama tha: "E kemi bërë të qartë e do vazhdojmë ta bëjmë të qartë që ne nuk do shpërndajmë më lëmshja mbijetese, apo lëmshja politike për njerëzit që jetojnë dhe punojnë në fshat". Ai foli për këto probleme gjatë një vizite në shtëpinë e një fermeri.



Shërbimet

"Janë 535 shërbime elektronike sot që garantojnë jo vetëm komunikimin në kohë reale, por edhe përgjigjen në kohë reale. Janë 29 dokumente me vullë dixhitale, gjenerohen nga sistemi dhe merren direkt nga shtëpia, duke nisur që nga certifikata e lindjes, nuk ka nevojë të shkohet në gjendje civile duke mbajtur radhë, por merret direkt online", tha dje Rama.

Kreu i PD-së: Çdo qytetar duhet të ngrihet për fatin e vet


Basha: Rama hoqi ndihmën ekonomike për 20 mijë familje, vepër kriminale

Kryetari i PD-së, Lulzim Basha, deklaroi dje se, "Rama mashtron dhe s'e beson askush, kur thotë se një qytetar preferon ndihmën ekonomike me 50 mijë lekë, në vend të punës me 300-400 mijë lekë në muaj. Ku janë këto vendet e punës që nuk i marrin shqiptarët, se pranokan më mirë dy thasë miell se sa 300-400 mijë lekë në një vend normal pune. Sigurisht që nuk janë dhe nuk janë as në fantazinë e Edi Ramës. Ai abuzon dhe fsheh të vërtetën dhe kjo është një vepër kriminale", tha Basha. Në një komunikim me gazetaret, kreu i PD-së u shpreh: "Mashtrimi i Ramës bëhet për të mbuluar të vërtetën e dhimbshme se në qeverinë e tij nuk ka vende të reja pune dhe se vendet e



punës po mbyllen çdo ditë". Sipas Bashës, "për ekskursionin në Berat, Edi Rama ka shpenzuar mjaftueshëm para për të paguar ndihmën ekonomike për të gjitha familjet e hequra në mënyrë abuzive në qarkun e Beratit". Duke komentuar deklaratat e Ramës për abuzime në listat e asistencës sociale, Basha tha: "Sigurisht ka, edhe mund të ketë

abuzues. Këta abuzues janë në këto lista, sepse i ka futur Edi Rama në këto lista dhe ne duam që çdo abuzues të largohet. Por ndërkohë janë 20 mijë familje, të cilat janë larguar pa asnjë shpjegim". Ai u bëri thirrje shqiptarëve të protestojnë dhe të mos e lejojnë kryeministrin t'i kërcënojnë me bukën e fëmijëve. "Merreni fatin tuaj në dorë, mos e lejojnë të vazhdojë më kjo farsë e shëmtuar! Ne nuk do t'i ndahemi asnjë sekondë kësaj emergjence kombëtare", tha Basha duke shtuar se, "organizimi i protestave, mbledhja dhe bashkimi në protestë është tubimi më i lartë i qytetarëve në demokraci. Opozitën e kanë dhe do ta kenë në krahun e tyre".



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
GJYKATA KUSHTETUESE
KOLEGJII I POSAÇËM I APELIMIT

SHPLLJE E VENDEVE VAKANTE

Kolegji i Posaçëm i Apelitit (KPA) pranë Gjykatës Kushtetuese, bazuar në ligjin nr. 84/2016, "Për Rivlerësimin Kalimtar të Gjyqtarëve dhe Prokurorëve në Republikën e Shqipërisë" dhe Vendimin e Kuvendit nr.92/2017 "Për miratimin e strukturës organizative, organikes dhe klasifikimit të pagave të personelit të Kolegjit të Posaçëm të Apelitit":

I - Rishpall 1 (një) vend vakant për pozicionin e "Përkthyesit"

Kandidati duhet të plotësojë kërkesat e posaçme si vijon:

- Të zotërojë diplomë të nivelit "Master Shkencor" në Gjuhë të Huaja, Dega Anglisht ose Drejtësi dhe të ketë minimum 5 vjet eksperiencë në përkthim Shqip- Anglisht - Shqip.
- Të ketë njohuri shumë të mira në terminologjinë ligjore në të dyja gjuhët.
- Kanë përparësi kandidatët me eksperiencë pune pranë organizatave ndërkombetare.

KUSHTE TË PËRGJITHSHME

- Kandidati duhet të sigurohet se plotëson kriteret për tu pajisur me Certifikatë Sigurie, sipas Vendimit Këshillit Ministrave nr.188, datë 4.3.2015.
- Kandidati duhet të ketë aftësi për tu përshtatur e punuar në grup, nën presion si dhe në afate kohore të limituara.

Të gjithë aplikimet duhet të dorëzohen nga data 12 Mars deri më 16 Mars 2018 në një nga format e dhëna më poshtë:

- Paraqitës së kërkesës nga aplikanti, së bashku me dokumentet përkatëse, pranë institucionit të KPA-së, në adresën: **Bulevardi "Dëshmorët e Kombit, Pallati i Kongreseve, Tiranë, nga e Hëna në të Premte, ora: 09:00-16:00.**
- Dërgimin e kërkesës së bashku me dokumentet përkatëse, me anë të postës zyrtare pranë institucionit të KPA-së në adresën: **"Bulevardi "Dëshmorët e Kombit, Pallati i Kongreseve, Tiranë. Aplikimi në trugë postare duhet të kryhet brenda datës 16 Mars 2018, i cili duhet të vërtetohet me fletë-mandatit e lëshuar nga institucioni përkatës postar. KPA-ja do të konfirmojë nëpërmjet postës elektronike marrjen e aplikimit përkatës.**
- Dërgimin e kërkesës së bashku me dokumentacionin përkatës me anë të postës elektronike nga data 12 Mars deri më 16 Mars 2018 në adresën: info@kpa.al.** KPA konfirmon nëpërmjet postës elektronike marrjen e aplikimit përkatës.

Në kërkesën që paraqet, kandidati përcakton vendin vakant, për të cilin është i interesuar të aplikojë. Bashkëlidhur me kërkesën, kandidati dorëzon 1 kopje të dokumenteve të mëposhtime:

- Jetëshkrim profesional, përfshirë të dhënat e kontaktit, postën elektronike zyrtare dhe adresën postare;
- Kopje të dokumentave (diplomë, letërnjoftimi (ID), librezë pune) original ose të noterizuar. Diplomat që janë marrë jashtë vendit, duhet të jenë njohur paraprakisht pranë institucionit përgjegjës për njehsimin e diplomave, sipas legjislacionit në fuqi;
- Dokument që vërteton se në ngarkim të tij nuk është regjistruar një procedim penal;
- Dëshmi e gjendjes gjyqësore;
- Vërtetim nga Institucioni që nuk ka masë disiplinore në fuqi;
- Vlerësimin e fundit nga Eprori Direkt;
- Cdo dokumentacion tjetër që vërteton plotësimin e kushteve të mësipërme, si dhe trajnime, kualifikime, arsimin shtesë, vlerësimet pozitive apo të tjera të përmendura në jetëshkrim.



Kryeministri
Edi Rama gjatë
vizitës në Berat

Operacioni Ndërko mbëtar i Monitorim it nuk do të bëjë me sa duket asnjë ankesë për vendimin e Komisionit të Pavarur të Kualifikimit për të ndërprerë procesin e vetingut për ish-kryeprokurotorin Adriatik Llalla. Në reagimet e këtij organizmi për mediat shqiptare në lidhje me mundësinë që ONM të vihete në lëvizje për të apeluar rastin e ish-Prokurorit të Përgjithshëm Adriatik Llalla, ndërsa vë në dukje se Komisioni i Pavarur i Kualifikimit ende nuk ka zbardhur arsyet për ndërprerjen e procesit të rivlerësimit për ish-anëtarin e Gjykatës Kushtetuese, Besnik Imeraj dhe ish-kryeprokurotorin Adriatik Llalla, ONM thekson se qëllimi i ligjit të vetingut është vetëm një. "Siç parashikohet në nenin 1 të ligjit të vetingut, të garantojë funksionimin e duhur të shtetit të së drejtës dhe pavarësinë e vërtetë të sistemit të drejtësisë. Për këtë arsye, procesi synon të pastrojë sistemin nga magjistratë që nuk përmbushin standardet e detyrës së tyre", citon "Vision Plus". Ligji për vetingun parashikon që prokurorët e gjyqtarët, të cilët do të jepnin dorëheqjen deri në pranverën e vitit të kaluar do t'i shpëtonin vetingut, por në

Operacioni Ndërkombëtar i Monitorimit: Qëllimi i vetingut, jo procedimi penal

Ndërprerja e vetingut për Llallën, ONM: Nuk e apelojmë, KPK ska dhënë arsye

"Dosjet e ish-subjekteve mund të hetohen sipas ligjit"



Shefja e Operacionit Ndërkombëtar të Monitorimit, Gjenovefa Ruiz Kalavera

atë kohë institucionet që do të bënin rivlerësimin, ende nuk ishin ngritur dhe vetëm 3 gjyqtarë e një prokuror vendosën të largoheshin nga detyra. ONM, në një tjetër

përgjigje për "Report TV" shprehet: "Qëllimi i vetingut nuk është që të zhvillojë procedura penale, por siç parashikohet në nenin 1 të ligjit të verifikimit, është ga-

KOMISIONI

Komisioni i Pavarur i Kualifikimit ka njoftuar shkurtimisht ndërprerjen e vetingut për ish-kryeprokurotorin Adriatik Llalla, pas dorëheqjes së tij, por edhe pas reagimit të DASH për shpalljen "non grata" të ish-Prokurorit të Përgjithshëm. Por, ende nuk ka arsye se përse e bëri këtë.

nuk i përmbushin standardet e funksioneve të tyre. Nëse sjellja e një subjekti apo (ish)subjekti të rivlerësimit sjell dyshime për vepra penale, dosjet e tyre përkatëse mund të përcillen përmes kanaleve të përshtatshme, siç parashikohet në legjislacionin shqiptar". Deri më tani, Komisioni i Pavarur i Kualifikimit ka njoftuar shkurtimisht ndërprerjen e vetingut për dy të dorëhequrit, por nuk ka dhënë informacion, nëse gjatë vlerësimit të dosjeve të tyre, ka gjetur apo jo elementë të dyshimë që mund të jenë objekt i Prokurorisë apo organeve të tjera ligjzbatuese, siç mund të jetë pasuria e pajustifikuar, apo kontaktet me persona të papërshtatshëm gjatë ushtrimit të detyrës.



Implemented by **giz** Deutsche Gesellschaft für Internationale Zusammenarbeit

Programme: Climate Change Adaptation in Transboundary Flood Risk Management, Western Balkans (CCAAB II)

The Deutsche Gesellschaft für Internationale Zusammenarbeit GmbH (GIZ) is a federal enterprise that supports the German Government in achieving its objectives in the field of international cooperation for sustainable development. The regional CCAAB II project assists Albania, Kosovo, Macedonia and Montenegro in the adaptation to impacts of climate change, particularly in the field of flood risk management. The project aims to contribute to the following improvements:

- Flood forecasts for the Drin River Basin are developed periodically
- A regional expert working group has agreed on a set of transboundary flood risk management measures
- The number of the people in the flood-affected areas who have the necessary knowledge of how to behave in an event of floods has increased.

For the support of the programme team, GIZ Office Albania is looking for a:

Driver/ logistic position

A. Responsibilities

The driver

- provides passenger transport in an official car for programme staff, official visitors and guests
- runs errands for the office, e.g. sending letters and messages, paying bills and buying office supplies
- helps with transporting goods
- completes the vehicle log correctly and conscientiously in accordance with GIZ standards
- assists with other office work.

B. Tasks

The driver

- cleans the interior and exterior of the vehicle(s) regularly
- checks oil, water, brakes and brake liquid, tyre pressure, battery levels and the entire vehicle regularly, headlights, brakes, bodywork for dents etc.
- is responsible for the project vehicle documents and their good condition, keeping a vehicle log and recording monthly maintenance
- calculates monthly petrol, oil and lubricant consumption for the daily cash fund and for forwarding monthly vouchers to cost accounting
- reports need for service and carries out minor repairs

- immediately reports all involvement of the project or office vehicle in accidents, including minor accidents, damage, loss or theft of vehicle fittings
- takes into account all available information on road conditions, accessible routes and locations.

Knowledge management

The driver

- uses all available information (including current radio news on traffic conditions) to update daily knowledge of road conditions, current passable routes and locations, and shares this information with other office drivers.

Other duties/additional tasks

The driver

- assists other colleagues as needed in other programmes if there is no travel pending,
- carries out other office work on request,
- supports the project team in the organisation of workshops and conferences.

C. Required qualifications, competences and experience

- secondary school education
- holds a valid driver's licence
- at least 5-7 years' work experience as a professional driver, with references
- no accidents in the past 3 years
- good knowledge of English, ideally knowledge of German
- discipline and punctuality
- resilience and patience
- appropriate appearance and attire (friendly manner with all passengers)
- ensures unrestricted availability of vehicles at all times and reports restrictions immediately
- willingness to upskill as required by the tasks to be performed – corresponding measures are agreed with management

Contract conditions:

- Full-time employment
- Programme office in Tirana, regularly missions to local partners in Shkodra and in the region (Kosovo, Montenegro and Macedonia).
- Assignment period: until August 2018.

Please forward your application until **4th March 2018**, to GIZ Office Albania by E-Mail: giz-albanien-hr@giz.de, including the following information: CV in English (Euro Pass format), references.

Only short-listed candidates will be contacted for interviews. They might be asked to bring certified copies of their diplomas and work certificates.

GIZ is an equal opportunity employer and welcomes applications from all interested groups without any discrimination!

PREFEKTET PASURITE

Zbardhen pasuritë e 11 prefektëve të emëruar nga Rama në 2017-ën

Prefektët, shtëpi në Tiranë dhe bregdet, ullishte e toka e bujqësore

Prefektja e Tiranës me tri apartamente, i Kukësit jeton me pension

Ornela Manjani

Apartamente në Tiranë e në bregdet, makina, ullishte e tokë bujqësore, të ardhura nga menaxhimi projektesh e pensionesh suplementare dhe llogari kursimi janë pasuritë e prefektëve të emëruar nga kryeministri Edi Rama në nëntor të vitit 2017. Sipas të ardhurave që deklarohen, prefektët janë të ndarë në pronarë shtëpish e tokash dhe ata që jetojnë me pensione të parakohshëm ose suplementar. Të dhënat janë sipas deklarimeve zyrtare të një viti të caktuar, apo deklarim fillestar përpara marrjes së detyrës, të cilat janë bërë publike nga "Open Spending Albania".

DEKLARIMI

Prefektët kanë deklaruar pranë Inspektoratit të Lartë

të Deklarimit të Pasurive pasuritë për vitin 2017 dhe më parë. Në deklarata janë edhe pasuritë e të ardhurat e pjesëtarëve të familjes. Referuar deklaratave të pasurisë, bie në sy pasuria e prefektes së Tiranës Suzana Jahollari, cila për vitin 2017 ka deklaruar si pasuri të paluajtshme një apartament banimi 2+1 me sipërfaqe 85 m² në Tiranë, për-

fituar me privatizim në vitin 1993, vlera në privatizim 23 778 lekë, një shtesë anësore e apartamentit të mësipërm me sipërfaqe 111 m², ndërtuar në vitet 1998-1999, legalizuar në vitin 2015, vlera 25 000 dollarë dhe një apartament banimi me sipërfaqe 39 m² në Golem, Kavajë, blerë më 19.01.2009, vlera 1 600 000 lekë. Ndërkohë, prefekti i qarkut të Fier-

it, Xhevit Bushaj është pronar i vetëm në dy shtëpi banimi në toka bujqësore dhe ullishte. "Pronar me 100 % i një apartamenti banimi me sipërfaqe 145.6 m², blerë me të ardhurat familjare, plus të ardhurat nga prodhimi bujqësor në fshat 1991-2004, vlera 6 200 000 lekë, pronar me 100 % i një shtëpie banimi në Fier në 400 m² truall, trashëguar nga prindërit;

pronar me 100% i një toke arë 11 220 m², përfituar sipas ligjit 7501 në komunën Frakull, Fier dhe pronar me 100% i një ullishteje me sipërfaqe 1820 m² plus vreshta me sipërfaqe 490 m² përfituar sipas ligjit 7501", - deklaroi pranë Inspektoratit të Lartë të Deklarimit të Pasurive, Xhevit Bushaj. Ndërsa prefekti i Kukësit, Zenel Kuçana ka

deklaruar pranë Inspektoratit të Lartë të Deklarimit të Pasurive një shtëpie banimi me sipërfaqe truall 263 m² dhe sipërfaqe ndërtese 152.2 m², me vlerë 5 116 203 lekë dhe një sipërfaqe ndërtimi prej 228.1 m², me vlerë 18 248 000 lekë dhe të ardhurat mujore prej 25 800 lekë në muaj, që i përfiton nga pensioni i parakohshëm.



Suzana JAHOLLARI

- Funkzioni dhe institucioni: **Prefekt - Qarku Tiranë**
- Koha e marrjes së detyrës/mandatit: **01-11-2017**
- Perfaqësues politik/i pavarur: -
- Persona të Familjes të përfshirë në Deklaratë: Bashkëshorti Z. Vasfi Jahollari, Vajza Briseida, Djali Artan

VITI 2017

Pasuri të paluajtshme

- 1) Pronare me 100% e një ap. banimi 2+1 me sip. 85 m² në Tiranë, përfituar me privatizim në vitin 1993, vlera në privatizim 23 778 lekë.
 - 2) Pronare me 100% e një shtesë anësore e apartamentit të mësipërm me sip. 111 m², ndërtuar në vitet 1998-1999, legalizuar në vitin 2015, vlera 25 000 dollar.
 - 3) Pronare me 100% e një ap. banimi me sip. 39 m² në Golem, Kavajë, blerë më 19.01.2009, vlera 1 600 000 lekë.
- Likuiditete (Depozita, Cash, Llogari rrjedhëse, Debi-Kredi, Karta krediti/debiti)
- 1) Depozitë bankare në bankë të nivelit të dytë ABI Bank, 1 800 000 lekë, kursime nga pagat.
 - 2) Depozitë bankare në bankë të nivelit të dytë, 7 000 euro kursime nga dieta dhe paga.
 - 3) Kartë krediti me limit 20 000 lekë.
 - 4) Kartë krediti me limit 250 euro.
 - 5) Depozitë bankare në emër të Vasfi Jahollari, shumë e transferuar nga Turqia nga djali Artan Jahollari, i cili ka punuar si kardiokirurg në një spital privat deri më 31.07.2017, 18 588 dollar.
 - 6) Djali Artan, depozitë bankare në bankë të nivelit të dytë, me kursime nga paga si kardiokirurg në Kosovë e Turqi, 8 000 euro.
 - 7) Djali Artan, depozitë bankare në bankë të nivelit të dytë, me kursime nga paga si kardiokirurg në Turqi, 20 000 dollar.
 - 8) Djali Artan, depozitë bankare në Turqi, 20 000 lira turke.

Automjete Djali Artan, pronar i një veture tip Audi A4, vit prodhimi 2008, blerë në Gusht 2017 për 10 500 euro, pas shitjes së makinës së mëparshme tip Hundai në Turqi.

Të tjera

- 1) Në nëntor 2017 është bërë kërkesë nga ana e Znj. Suzana si Kryetare për c'rrëgjistrim në Gjykatë të OJF "Gratë në Forcat e Armatosura të RSH", e cila më parë ka qenë në status pasiv.
- 2) Djali, Artan Jahollari, rregjistruar si Person Fizik dhe ofron shërbime kontraktuale si kirurg kardiovaskular në Spitalin Amerikan
- 3) Zonja Jahollari ka marrë nga data 1 janar deri në datën 30 tetor, datë e marrjes së detyrës, pension të parakohshëm ushtarak totali 271 000 lekë.
- 4) Bashkëshorti për periudhën 1 janar deri 30 tetor ka marrë pension pleqërie në vlerën 271 000 lekë dhe pension ushtarak të parakohshëm 98 700 lekë.



Roland NASTO

- Funkzioni dhe institucioni: **Prefekt - Qarku Durrës**
- Koha e marrjes së detyrës/mandatit: **01-11-2017**
- Persona të Familjes të përfshirë në Deklaratë: Bashkëshortja Znj. Anila Nasto, Vajza Megi, Djali Soti

VITIT 2011

Pasuri të paluajtshme Blerë më 18.08.2005 ap. banimi 2 plus 1 me sip. 100 m² në Durrës, 4 500 000 lekë, me para nga shitja e ap. banimi dhuruar nga babai (4 000 000 lekë) dhe një shtesë nga kursime familjare (500 000 lekë), disponoj dokument hipotekor te datës 15.09.2005.

Likuiditete (Depozita, Cash, Llogari rrjedhëse, Debi-Kredi, Karta krediti/debiti)

- 1) Gjendje llogari bankare më 03.06.2011, 357 673 lekë.
- 2) Gjendje llogari bankare e pandryshuar, 3 092 762 lekë.
- 3) Gjendje depozitë bankare më 08.03.2011, vlera 1 000 000 lekë.

Të tjera

- 1) Të ardhura nga paga 96 550 lekë në muaj.
- 2) Bashkëshortja, të ardhura nga paga 45 000 lekë në muaj.
- 3) Babai, pension pleqërie, 16 800 lekë në muaj.

VITI 2017

Pasuri të paluajtshme Pronar i një ap. banimi 2 plus 1 me sip. 100 m² në Durrës, blerë më 18.08.2005, 4 600 000 lekë, dokument hipotekor i datës 15.09.2005.

Likuiditete (Depozita, Cash, Llogari rrjedhëse, Debi-Kredi, Karta krediti/debiti)

- 1) Gjendje llogari bankare më 11.11.2017, shuma 87 772 lekë.
 - 2) Gjendje llogari bankare e pandryshuar, 3 092 762 lekë, së bashku me bashkëshorten.
 - 3) Depozitë bankare, 900 000 lekë.
 - 4) Gjendje kursime cash, 5 000 euro.
 - 5) Bashkëshortja, kartë krediti hapur në vitin 2015, me limit 100 000 lekë, detyrim i pashlyer deri më 09.11.2017, 56 048 lekë.
 - 6) Bashkëshortja, gjendje llogarisë së pagës më 09.11.2017, 5 850 lekë.
 - 7) Vajza, gjendje llogarisë së pagës më 13.11.2017, vlera 6 730 lekë.
 - 8) Vajza, depozitë bankare çelur më 10.11.2017 në shumën 5 000 euro, me trashëgimi nga gjyshërit dhe kursime.
 - 9) Djali, depozitë bankare çelur më 10.11.2017 në shumën 5 000 euro, me trashëgimi nga gjyshërit dhe kursime.
 - 10) Djali, gjendje llogarisë së pagës, 15 995 lekë.
- Automjete Bashkëpronar me djalin i një veture tip Volkswagen Pasat, prodhim i vitit 2001, blerë më 29.08.2013 për 5 000 euro.

Të tjera

- 1) Të ardhura nga paga 73 000 lekë në muaj.
- 2) Bashkëshortja, të ardhura nga paga 50 300 lekë në muaj.
- 3) Vajza, të ardhura nga paga 48 900 lekë në muaj.



Astrit ALIAJ

- Funkzioni dhe institucioni
- Koha e marrjes së detyrës/mandatit
- Perfaqësues politik/
- Deklarata sipas ILDKP me Numër Indeks: - Shiko deklaratën para fillimit të detyres 2017
- Persona të Familjes të përfshirë në Deklaratë: Bashkëshortja, Znj. Vjollca Aliaj, Vajza Alketa Aliaj, Vajza Dorela Aliaj

Prefekt - Qarku Gjirokastrë
01-11-2017
 I pavarur
 - Shiko deklaratën para fillimit të detyres 2017

VITI 2017

Pasuri të paluajtshme

- 1) Pronar i një ap. banimi 2 plus 1, me sip. 86.32 m2 në Vlorë, ndërtaur në vitin 1961, përfutur me privatizim për 2 690 lekë.
- 2) Pronar me 100% i një shtese ballkoni në katin e dytë të pallatit me sip. 39 m2, me leje ndërtime nga KRRT e rrethit Vlorë, vlerësuar me koston mesatare të tregut të ndërtimeve në Vlorë 61 800 lekë për m2 ose në total 1 267 812 lekë, për të cilën nuk është pajisura akoma me certifikatë pronësie.
- 3) Vajza Alketa Aliaj, dhe Dorela Aliaj bashkëpronare me secila 50% e një ap. banimi me sip. 80.17 m2 në Tiranë, blerë më 07.02.2012 për vlerën totale prej 4 630 000 lekë, nga të cilat 3 030 000 lekë janë kursime nga prindërit dhe 1 600 000 lekë dhuratë nga gjyshërit.

Të tjera

- 1) Të ardhura nga paga 1 Janar-31 Tetor 2017, pozicioni i punës Drejtor i Drejtorisë së Planifikimit dhe Shërbimeve Mbështetëse në Qendrën Ndërinstitucionale Operacionale Detare Durrës 804 562 lekë.
- 2) Të ardhura nga pension i parakohshëm si ish ushtarak, 1 Janar-31 Tetor 2017, 130 000 lekë.
- 3) Bashkëshortja, të ardhura nga paga pranë Sigal 1 Janar-31 Tetor 2017, 798 908 lekë.
- 4) Vajza, bursë doktorature, 1 Janar-30 Tetor 2017, nga Universiteti i Bergamos Itali 11 365 euro.



Sadi VORPSI

- Funkzioni dhe institucioni
- Koha e marrjes së detyrës/mandatit
- Funkzioni dhe institucioni
- Koha e marrjes së detyrës/mandatit

Prefekt - Qarku Tiranë
04-10-2013
 Deputet i Parlamentit - Kuvendi i Shqipërisë
09-09-2017

VITIT 2013

Pasuri të paluajtshme

- 1) Pronar me 50 % (në bashkëpronësi me nënën) i një ap. banimi me sip. 100 m2, përfutur me kontratën e sipërmarrjes dt. 14.02.2000 në këmbim të pronësisë së deklaruesit dhe nënës së tij përfutur me anë të trashëgimisë.
 - 2) Pronar me 50 % (në bashkëpronësi me nënën) i një ap. banimi me sip. 98 m2, përfutur me kontratën e sipërmarrjes dt. 14.02.2000 në këmbim të pronësisë së deklaruesit dhe nënës së tij përfutur me anë të trashëgimisë.
 - 3) Pronar me 50 % (në bashkëpronësi me nënën) i një bodrumi me sip. 11.5 m2, përfutur me kontratën e sipërmarrjes dt. 14.02.2000 në këmbim të pronësisë së deklaruesit dhe nënës së tij përfutur me anë të trashëgimisë.
 - 4) Pronar me 50 % (në bashkëpronësi me nënën) i një zyre me sip. 25 m2, përfutur me kontratën e sipërmarrjes dt. 14.02.2000 në këmbim të pronësisë së deklaruesit dhe nënës së tij përfutur me anë të trashëgimisë.
 - 5) Pronar me 50 % i një dyqani me sip. 71 m2 në Vlorë, blerë në vitin 2003 dhe hipotekuar më 27.03.2009 me të ardhura nga aktiviteti privat, vlera 50 000 dollarë.
 - 6) Bashkëshortja, Znj. Arba Vorpsi, pronare me 20 % e një ap. banimi me sip. 78.5 m2 në Tiranë, përfutur nga privatizimi, vlera 15 232 lekë.
- Likuiditete (Depozita, Cash, Llogari rrjedhëse, Debi-Kredi, Karta krediti/debiti)**
- 1) Gjendja e depozitës bankare në një bankë të nivelit të dytë në emër të deklaruesit dhe nënës së tij, 2 000 005 lekë.
 - 2) Gjendja e depozitës bankare në një bankë të nivelit të dytë në emër të deklaruesit dhe nënës së tij, 5 000.37 dollarë.
 - 3) Gjendja e depozitës bankare në një bankë të nivelit të dytë në emër të nënës së deklaruesit, 4 166.71 euro.
 - 4) Gjendja e depozitës bankare në një bankë të nivelit të dytë në emër të deklaruesit dhe nënës së tij, të ardhura ndër vite, trashëgimi dhe aktiviteti privat, 35 103.35 euro.
 - 5) Gjendja cash, të ardhura në vite, trashëgimi, aktiviteti privat, 20 000 euro.
 - 6) Kredi bankare në një bankë të nivelit të dytë marrë në vitin 2007, 130 000 euro.
- Detyrimi i mbetur pashlyer, 12 119 euro.**

Automjete

- 1) Pronar me 100 % i një automjeti tip 'Tuareg', blerë me të ardhurat në vite dhe trashëgimi, vlera 15 000 euro plus 554 009 lekë zhdoganimi.
 - 2) Bashkëshortja, Znj. Arba Vorpsi, pronare me 100 % e një automjeti tip 'Shvrolet Kalos', blerë me të ardhura familjare, 10 700 euro.
- Të tjera**
- 1) Të ardhura nga paga (01.01.2013 - 04.10.2013.), 312 640 lekë.
 - 2) Bashkëshortja, Znj. Arba Vorpsi, të ardhura nga paga (01.01.2013 - 04.10.2013.), 200 456 lekë.
 - 3) Të ardhura nga shitja e aksioneve të shoqërisë më 06.09.2013 në vlerën 100 000 lekë.

VITI 2017

Pasuri të paluajtshme

- Nuk ka**
- Likuiditete (Depozita, Cash, Llogari rrjedhëse, Debi-Kredi, Karta krediti/debiti)**
- 1) Gjendja cash, 3 067.1 euro.
 - 2) Gjendja cash, 76 442 lekë.
 - 3) Gjendja cash, 43.71 dollarë.
 - 4) Kredi bankare për mbulimin e kartës së kreditit me limit 460 000 lekë. detyrimi i shlyer plotësisht 460 000 lekë.
- Të tjera**
- 1) Të ardhura nga paga, 383 218 lekë.
 - 2) Të ardhura nga interesat e depozitës bankare 2 026 350.93 lekë që është në emër të deklaruesit dhe nënës së tij, 92 qindarka.
 - 3) Të ardhura nga interesat e depozitës bankare 5 170.29 dollarë që është në emër të deklaruesit dhe nënës së tij, 43.32 dollarë.
 - 4) Të ardhura nga interesat e depozitës bankare në vlerën 30 093.29 euro, 15.87 euro.
 - 5) Bashkëshortja, Znj. Arba Vorpsi, të ardhura nga paga 97 680 lekë.



Xhevit BUSHAJ

- Funkzioni dhe institucioni
- Koha e marrjes së detyrës/mandatit
- Funkzioni dhe institucioni
- Persona të Familjes të përfshirë në Deklaratë: Bashkëshortja, Znj. Luljeta Bushaj; Djali, Z. Ardit Bushaj; Djali, Z. Amarildo Bushaj; Bashkëshortja e djalit, Arditi, Edra Bushi

Deputet i Parlamentit - Kuvendi i Shqipërisë
09-09-2017
Prefekt - Qarku Fier

VITI 2013

Pasuri të paluajtshme

- 1) Pronar me 100 % i një ap. banimi me sip. 145.6 m2 blerë më të ardhurat familjare plus të ardhurat nga prodhimi bujqësor në fshat 1991-2004, vlera 6 200 000 lekë.
 - 2) Pronar me 100 % i një shtëpie banimi në Fier në 400 m2 truall, trashëguar nga prindërit.
 - 3) Pronar me 100 % i një toke arë 11 220 m2, përfutur sipas ligjit 7501 në komunën Frakull, Fier.
 - 4) Pronar me 100 % i një ullishte me sip. 1820 m2 plus vreshta me sip. 490 m2 përfutur sipas ligjit 7501.
- Likuiditete (Depozita, Cash, Llogari rrjedhëse, Debi-Kredi, Karta krediti/debiti)**
- 1) Gjendja e depozitës bankare në një bankë të nivelit të dytë, më 04.10.2015, të ardhura nga shitja e shtëpisë përfutur nga ATK, 35 000 euro.
 - 2) Gjendja e depozitës bankare në një bankë të nivelit të dytë, të ardhura nga shpërbilimi për largim nga RZH plus të ardhura nga prodhimet bujqësore, 3 469 400 lekë.
- Automjete** Pronar me 100 % i një autoveture tip 'Benz' blerë me të ardhura familjare dhe të ardhura nga prodhimet bujqësore, vlera 1 000 000 lekë.

Sende me vlerë

- Nuk ka**
- Tituj Financiarë (Bono thesari, obligacione, letra me vlerë, fonde sigurie, aksione në bursë, shërbime financiare të parapaguara) Bono thesari në Bankën e Shqipërisë, të ardhura nga kursime, interesa bankare plus të ardhura nga prodhimet bujqësore 1991-2008, 4 500 000 lekë.

Dhurata

- Nuk ka**
- Të tjera**
- 1) Të ardhura nga paga neto (janar - 4 tetor 2013), si sekretar i Këshillit Bashkiak Fier, 76 000 lekë.
 - 2) Të ardhura si anëtar i bordit të sh.a KK, Fier, 26 300 lekë.
 - 3) Të ardhura nga shitja e prodhimit bujqësor dhe blektoral në Frakull të Vogël, Komuna Frakull.
 - 4) Të ardhura nga prodhimi bujqësor e blektoral, 1 800 000 lekë.
 - 5) Bashkëshortja, Znj. Luljeta Bushaj, të ardhura nga paga neto (1 janar - 4 tetor 2013), si infermiere në Fier, 41 500 lekë.
 - 6) Djali, të ardhura nga paga neto (1 janar - 4 tetor 2013), 25 000 lekë.

VITI 2016

- Të ardhura nga Paga dhe Shpërbilimet Të ardhura nga paga si prefekt i Qarkut Fier për vitin 2016, 1 019 990 lekë.
- Të ardhura si Këshilltarë/Anëtarë Bordesh
- Të ardhura nga interesa bankare dhe të kredidhënies
- 1) Të ardhura nga interesat e depozitave për vitin 2016, 74 423 lekë.
 - 2) Të ardhura nga interesat e obligacioneve për vitin 2016 pranë Bankës së Shqipërisë, 392 000 lekë.
- Të ardhura të personave pjesë e Certifikatës Familjare**
- 1) Bashkëshortja, Znj. Luljeta Bushaj, të ardhura nga paga për vitin 2016 si kryeinfermiere pranë qendrës shëndetësore lagjia '11 janari', 528 000 lekë.
 - 2) Djali, Z. Ardit Bushaj, të ardhura nga paga për vitin 2016, 80 730 lekë.
 - 3) Djali, Z. Ardit Bushaj, të ardhura nga paga për vitin 2016 pranë Albpetrol sh.a, 806 190 lekë.
 - 4) Bashkëshortja e djalit, Arditi, Edra Bushi, të ardhura nga paga neto për vitin 2016 si mësuese pranë Shkollës së Mesme të Përgjithshme 'Janaq Kiliça', Fier, 550 900 lekë.
- Të tjera** Të ardhura nga shitja e prodhimeve bujqësore dhe fruti-kulturë në Frakull e Vogël, Komuna Frakull, Qarku Fier, 750 000 lekë.



Flamur MAMAJ

- Funkzioni dhe institucioni
- Koha e marrjes së detyrës/mandatit
- Persona të Familjes të përfshirë në Deklaratë: Bashkëshortja, Znj. Arta Mamaj, Vajza Enejda, Vajza Fjoralba, Djali

Prefekt - Qarku Vlorë
01-11-2017

VITIT 2017

Pasuri të paluajtshme

- 1) Pronar me 100% i një ap. banimi me sip. 59.5 m2 në Vlorë, nga të cilat 68.75% blerë sipas kontratës së datës 14.07.2006 për 700 000 lekë dhe 31.25% përfutur me trashëgimi.
 - 2) Bashkëpronar i një pasurie të llojit kullotë verore me sip. 77 ha në fshatin Dhëmbllan, Tepelenë, dhënë nga Gjykata e Apelit Gjirokastrë pjesa takuese prej 1.83 ha. Likuiditete (Depozita, Cash, Llogari rrjedhëse, Debi-Kredi, Karta krediti/debiti)
 - 1) Llogari bankare, gjendje 117 euro.
 - 2) Llogari bankare, gjendje 0 lekë.
 - 3) Llogari bankare, gjendje më 01.11.2017, 33 300 lekë.
 - 4) Gjendje para cash, 1 500 000 lekë, kursime ndër vite dhe të ardhura nga shoqëria FPM shpk.
 - 5) Djali, llogari kursimi me kursime nga paga e së ëmës, 366 075 lekë.
- Automjete** Bashkëshortja, Znj. Arta Mamaj, pronare e një veture tip Mercedes Benz, vendosur në emrin e shoqërisë FPM shpk, 18 000 euro.

Sende me vlerë

- Nuk zotëron**
- Tituj Financiarë (Bono thesari, obligacione, letra me vlerë, fonde sigurie, aksione në bursë, shërbime financiare të parapaguara) Bashkëshortja, Znj. Arta Mamaj, pronare e vetme e shoqërisë FPM shpk.
- Dhurata** **Nuk zotëron**
- Të tjera**
- 1) Të ardhura nga paga 1 Janar-30 Tetor 2017, 524 487 lekë.
 - 2) Bashkëshortja Arta, të ardhura nga paga 1 Janar-1 Nëntor 2017, 359 000 lekë.
 - 3) Dhënë hua vëllait për blerjen e një ap. banimi në vlerën 60 000 euro, kursime nga fitimet e aktivitetit tregtar të bashkëshortëve.



Nexhmedin SHEHU

- Funkzioni dhe institucioni **Prefekt - Qarku Dibër**
- Koha e marrjes së detyrës/mandatit **01-11-2017**
- Perfaqësues politik/ **I pavarur**
- Deklarata sipas ILDKP me Numër Indeksi: Shiko deklaratën para fillimit të detyres 2017
- Persona të Familjes të përfshirë në Deklaratë: Bashkëshortja, Znj. Dhurata Shehu, Djali Ismail Shehu, Vajza Ana Shehu, Babai Mehmet Shehu asuri të paluajitshme

Pasuri të paluajitshme
 1) Bashkëshortët, pronar të një shtëpie private banimi 2-katërshe, me sip. 247.6 m² dhe sip. e parcelës ndërtimore 267.8 m², ndërtuar me kontributet familjare dhe e legalizuar, 6 503 043 lekë.
 2) Djali Ismaili së bashku me bashkëshorten, pronarë të një ap. banimi me sip. 71.1 m², 35 000 euro.

Likuiditete (Depozita, Cash, Llogari rrjedhëse, Debi-Kredi, Karta krediti/debiti)

- 1) Depozitë bankare me kursime familjare, 3 000 000 lekë.
- 2) Depozitë bankare me kursime familjare, 2 000 000 lekë.
- 3) Llogari bankare e pagës, gjendje 100 000 lekë.
- 4) Bashkëshortja, llogari bankare e pagës, gjendje 160 000 lekë.
- 5) Babai, gjendje depozitë bankare, 5 000 000 lekë.
- 6) Vajza, llogari bankare e pagës, gjendje 14 500 euro.
- 7) Djali Ismaili, llogari kursimi, gjendje 400 000 lekë.
- 8) Djali Ismaili së bashku me bashkëshorten, gjendje e llogarive të pagës, 40 200 lekë.
- 9) Djali Ismaili, gjendje kursime cash, 100 000 lekë.

Automjete

- 1) Pronar i një veture tip Benz, prodhim i vitit 2001, 200 000 lekë.
- 2) Djali Ismaili, pronar i një veture tip Benz, prodhim i vitit 2003, 3 000 euro.



Baki BALA

- Funkzioni dhe institucioni **Prefekt - Qarku Fier**
- Koha e marrjes së detyrës/mandatit **01-11-2017**
- Persona të Familjes të përfshirë në Deklaratë: Bashkëshortja, Znj. Valentina Bala

VITI 2003
 Pasuri të paluajitshme Pronar i një ap. banimi 3+1 me sip. 87 m², 1 650 000 lekë, pjesërisht nga Enti kombëtar i Banesave dhe pjesërisht nga shitje banese. Deklaruesi i detyrohet EKB 700 000 lekë në momentin e deklarimit, e cila do të shlyhet për 8 vjet.

Likuiditete (Depozita, Cash, Llogari rrjedhëse, Debi-Kredi, Karta krediti/debiti)

- 1) Kursime cash, 500 000 lekë.
- 2) Kursime, 1 050 000 lekë.

Automjete Pronar i një veture, blerë me kursime personale, 450 000 lekë.

Të tjera

- 1) Të ardhura nga paga 890 000 lekë.
- 2) Bashkëshortja, të ardhura nga paga, 100 000 lekë.

VITIT 2014

Të ardhura nga Paga dhe Shpërblimet
 1) Të ardhura nga paga si Drejtor i Drejtorisë së Menaxhimit të Projekteve, Janar-Gusht 2014, 700 920 lekë.
 2) Të ardhura nga pension suplementar si ushtarak në lirim, Janar-Gusht 2014, 96 000 lekë.

Të ardhura të personave pjesë e Certifikatës Familjare

- 1) Bashkëshortja, Znj. Valentina Bala, të ardhura nga paga si specialiste në ASNI, Janar-Gusht 2014, 260 000 lekë.
 - 2) Vajza Edlira, të ardhura nga paga, Janar-Gusht 2014, 800 000 lekë.
- Të Ardhura nga Detyrime të Shlyera nga të Tretë/Nuk ka
 Të ardhura vjetore si % ndaj të ardhurave të pagës nga ky funksion

Të tjera

- 1) Vajza Edlira, mbyllur depozitë me afat dhe shumën prej 454 000 lekë, depozituar në llogari të re.
- 2) Vajza Edlira, mbyllur llogari kursimi në shumën 80 000 lekë.



Zenel KUÇANA

- Funkzioni dhe institucioni **Prefekt - Qarku Kukës**
- Koha e marrjes së detyrës/mandatit **01-11-2017**
- Perfaqësues politik/ **pavarur**
- Persona të Familjes të përfshirë në Deklaratë: Bashkëshortja, Znj. Rabie Kuçana

Pasuri të paluajitshme
 1) Pronar i një shtëpie banimi me sip. trualli 263 m² dhe sip. ndërtese 152.2 m², 5 116 203 lekë.
 2) Pronar i një sipërfaqe ndërtimi prej 228.1 m², 18 248 000 lekë.

Likuiditete (Depozita, Cash, Llogari rrjedhëse, Debi-Kredi, Karta krediti/debiti) Nuk zotëron

Automjete Nuk zotëron

Të tjera Përfutur pension i parakohshëm, 25 800 lekë në muaj, 309 600 lekë në vit.



Harilla DAFA

- Funkzioni dhe institucioni **Prefekt - Qarku Berat**
- Koha e marrjes së detyrës/mandatit **01-11-2017**
- Perfaqësues politik/ **I pavarur**
- Deklarata sipas ILDKP me Numër Indeksi: - Shiko deklaratën para fillimit të detyres 2017
- Persona të Familjes të përfshirë në Deklaratë: Bashkëshortja, Znj. Eftimi Dafa, Djali Ditiqon, Djali Alban

Pasuri të paluajitshme
 1) Pronar me 100% i një ap. banimi me sip. 70 m² në Vlorë, blerë më 03.08.2011 ish objekti ushtarak me autorizim të Ministrisë së Mbrojtjes dhe nëpërmjet Entit Kombëtar të Banesave Vlorë, 275 397 lekë. Apartamenti është i regjistruar në bashkëpronësi me bashkëshorten dhe dy djemtë.

2) Bashkëpronar me 33.3% i një ap. banimi me sip. 48.5 m² në Vlorë, trashëguar nga nëna. Likuiditete (Depozita, Cash, Llogari rrjedhëse, Debi-Kredi, Karta krediti/debiti)

- 1) Depozitë kursimi çelur më 07.02.2014 me të ardhura nga kursimet e bursës gjatë studimeve në SHBA në vitet 2003-2004, gjendje më 01.11.2017, 1 641 euro.
- 2) Llogari bankare e pagës, gjendje më 01.11.2017, 0 lekë.
- 3) Llogari bankare e pagës (pensionit si ish ushtarak), gjendje më 01.11.2017, 0 lekë.
- 4) Depozitë kursimi çelur më 05.02.2005 me të ardhura nga kursimet e bursës gjatë studimeve në SHBA në vitet 2003-2004, gjendje më 01.11.2017, 3 dollar. Depozita është mbyllur më 15.11.2017.

5) Depozitë kursimi çelur më 12.04.2008 me të ardhura nga kursimet e bursës gjatë studimeve në SHBA në vitet 2003-2004, gjendje më 01.11.2017, 4 euro. Depozita është mbyllur më 15.11.2017.

6) Bashkëshortja, Znj. Eftimi Dafa, depozitë kursimi çelur më 20.09.2013 me të ardhura nga kursimet e bursës së bashkëshortit gjatë studimeve në SHBA në vitet 2003-2004, gjendje më 01.11.2017, 3 248 euro.

7) Djali Ditiqon, depozitë kursimi çelur më 12.05.2017 me të ardhura nga paga si asistent lektor në Kolegjin Universitar Pavarësia, gjendje më 01.11.2017, 40 023 lekë.

8) Djali Ditiqon, llogari bankare e pagës, gjendje më 01.11.2017, 10 522 lekë.

9) Djali, Alban, depozitë kursimi çelur më 14.09.2016 me të ardhura nga kursimet e bursës gjatë studimeve në Britaninë e Madhe në vitet 2015-2016, gjendje më 01.11.2017, 3 990 paund.

10) Djali, Alban, depozitë kursimi çelur më 08.08.2014 me të ardhura nga kursimet e bursës gjatë studimeve në SHBA në vitet 2007-2011, gjendje më 01.11.2017, 7 411 euro.

11) Djali Alban, llogari bankare e pagës, gjendje më 01.11.2017, 835 lekë.

Automjete Nuk zotëron

Sendë me vlerë Nuk zotëron
 Tituj Financiarë (Bono thesari, obligacione, letra me vlerë, fonde sigurie, aksione në bursë, shërbime financiare të parapaguara) Nuk zotëron

Dhurata Nuk zotëron



Çesk MILLJA

- Funkzioni dhe institucioni **Prefekt - Qarku Shkodër**
- Koha e marrjes së detyrës/mandatit **01-11-2017**
- Persona të Familjes të përfshirë në Deklaratë: Bashkëshortja, Znj. Rita Millja

VITI 2006
 Pasuri të paluajitshme
 1) Bashkëshortët pronarë të një njësie në Tiranë, blerë më 26.11.2003 me të ardhura nga pagat dhe aktivitet personal ndër vite, 5 563 200 lekë. Zotërojnë certifikatë pronësie të datës 02.03.2012.

2) Bashkëshortët pronarë të një ap. banimi me sip. 56 m² në Tiranë, blerë më 26.11.2003 me të ardhura nga pagat dhe aktivitet personal ndër vite, 2 596 160 lekë. Zotërojnë certifikatë pronësie të datës 02.03.2012.

3) Bashkëshortët pronarë të një ap. banimi me sip. 58.7 m² në Tiranë, blerë më 26.11.2003 me të ardhura nga pagat dhe aktivitet personal ndër vite, 2 721 133 lekë. Zotërojnë certifikatë pronësie të datës 02.03.2012.

4) Bashkëshortët pronarë të një ap. banimi me sip. 79.8 m² në Tiranë, blerë më 26.11.2003 me të ardhura nga pagat dhe aktivitet personal ndër vite, 3 699 528 lekë. Zotërojnë certifikatë pronësie të datës 02.03.2012.

Likuiditete (Depozita, Cash, Llogari rrjedhëse, Debi-Kredi, Karta krediti/debiti) Depozitë bankare me të ardhura nga paga e qira, 1 900 000 lekë.

hurata Bashkëshortët pronarë të një ap. banimi me sip. 99.93 m² në Tiranë, dhuruar nga familja e bashkëshortes, për të cilën për efekt kalimi pronësie është bërë kontratë shit-blejje më 08.11.2010 në vlerën 100 euro.

Të tjera

- 1) Të ardhura nga pension i parakohshëm i ushtarakut, 300 000 lekë.
- 2) Bashkëshortja, të ardhura nga paga 260 000 lekë.
- 3) Të ardhura nga qira ap. me sip. 99.93 m², 10 muaj, 6 000 euro.
- 4) Të ardhura nga qira e dy ap. me sip. 56 m² dhe 58.7 m², 10 muaj, 5 000 euro.
- 5) Të ardhura nga qira njësie me sip. 60 m², 10 muaj, 400 000 lekë.

2011

Të ardhura nga Paga dhe Shpërblimet Të ardhura nga paga si Drejtor i Drejtorisë së Ndërlidhjes së Shtabit të Përgjithshëm, 1 044 000 lekë.

Të ardhura të personave pjesë e Certifikatës Familjare Bashkëshortja, të ardhura nga paga si mësuese, 480 000 lekë.

Arrestohet drejtuesi i mjetit Halil Koka, tentoi t'ia linte fajin të dashurës. Policia: Shkak, shpejtësia e lagështira

I përplas "Toyota", humbin jetën vjehëri dhe nusja

Dy viktimat ishin në anë të rrugës, plagoset rëndë edhe djali 8 vjeç

Klodiana Haxhiaj

KAVAJË

Tragjeditë në rrugë nuk kanë të ndalur. Dy pjesëtarë të një familjeje në Golem të Kavajës humbën dje jetën në aksident, pasi u përplasën nga një automjet tip "Toyota" me targë AA686OL, i cili ka dalë nga rruga dhe më pas është përmbysur. Burime zyrtare nga policia lokale bënë me dije se nga përplasia e fortë mbetën të vdekur në vend 69-vjeçari Xhemal Fisku dhe nusja e djalit të tij, Edlira Fisku 34 vjeçe. Ndërsa ka mbetur i plagosur rëndë dhe djali 8 vjeç i kësaj familjeje, i cili u dërgua urgjentisht në Spitalin e Traumës në Tiranë. Mësohet se ngjarja e rëndë ndodhi rreth orës 07:40 në vendin e quajtur Mali i Robit në aksin Golem-Kavajë. Sipas bluve, dy viktimat ishin duke pritur në anë të rrugës, kur u përplasën nga automjeti që lëvizte nga Plepat në drejtim të Kavajës dhe që drejtohej nga 40-vjeçari Halil Koka nga Durrësi. Pas njoftimit për aksidentin tragjik, policia ka shkruar menjëherë në vendngjarje dhe pas kryerjes së veprimeve hetimore paraprahe ka arrestuar në flagrancë Kokën, i cili akuzohet për shkelje të rregullave të qarkullimit rrugor me pasojë vdekjen. Fillimisht u raportua nga policia se automjeti që përplasi nënën 34-vjeçare Edlira Fisku dhe vjehërin e saj drejtohej nga 30-vjeçarja Ilda Parroji, por nga kryerja e veprimeve hetimore ka rezultuar se autor i aksidentit ishte 40-vjeçari. Ky i fundit madje është edhe pa patentë, pasi i ishte hequr pak ditë më parë nga policia. Ndërsa, po hetohet në gjendje të lirë për dëshmi të rreme e dashura e autorit të aksidentit, pasi fillimisht ka deklaruar se ishte ajo që drej-



Vendi ku ndodhi aksidenti me dy të vdekur dhe një të plagosur



VIKTIMA
Gjatë kësaj jave humbën jetën 8 persona në tre aksidente automobilistike. Mbrëmjen e së dielës që shkoi, pas përplases së dy njeteve në Veilipojë, u shua familja Preka. Në këtë aksident humbën jetën 40-vjeçari Edmond Preka, dy vajzat dhe djali i tij. Ndërsa u plagos rëndë bashkëshortja 36 vjeçe si dhe dy persona të tjerë, që ndodheshin në mjetin tjetër. Ndërsa, mesnatën e 21 shkurtit humbën jetën në një aksident në autostradën Tiranë-Durrës (afër Maminasit), taksisti 60-vjeçar Bujar Agalliu dhe 23-vjeçarja Elena Avdillari. Mëngjesin e djeshëm humbën jetën edhe dy pjesëtarë të familjes Pisku në Golem.

tonte makinën. Ndërkohë, burimet e mësipërme pohuan se dyshohet që aksidenti është shkaktuar nga

Vjehërra e 34-vjeçares vë kujën: Kë të qaj më parë

Familja Pisku në Golem hap dyert e mortit: Edlira dhe kryefamiljari po shkonin në Berat

KAVAJË - Pas aksidentit tragjik, familja Pisku në Golem ka hapur dyert e mortit. Në vilën trekatëshe, ku jetojnë pesë djemtë e kësaj familjeje, dje hynin e dilnin njëerë për ngushëllim. Ndërkohë që familjarët e viktimave janë të tronditur nga humbja e kryefamiljarit dhe nuses. Mes lotëve, e zonja e shpëtitëse dhe qante e bërtiste: "Kë të qaj më parë... nusen që më la dy fëmijë jetimë apo tim shoq". Të



afërm të dy viktimave u shprehën se 34-vjeçarja Edlira Pisku kur ka parë makinën që po afrohej me shpe-

jtësi, ka mbrojtur me trupin e saj të birin, i cili fatmirësisht ndodhet jashtë rrezikut për jetën në Spitalin e Traumës. Gjithashtu, familjarët thanë se bashkëshorti i Edlirës dhe tre vëllezërit e tij punonin në ndërtim në Greqi. Ata pohuan se 10 ditë më parë, bashkëshorti i 34-vjeçares ishte në Shqipëri ku kishte qëndruar për dy ditë, ndërsa tani do të kthehet për mort.

shpejtësia e madhe e automjetit në fjalë dhe lagështira në rrugë.

AKSIDENTI TRAGJIK

Mbrëmjen e së premtes, Edlira Pisku është telefonuar nga nëna e saj, e cila e ka lajmëruar se gjyshja e kësaj të fundit ishte e sëmurë rëndë, madje për këtë ishte kthyer edhe vëllai i saj nga Greqia. Pas marrjes së lajmit, 34-vjeçarja ka vendosur të nisej për në Berat së bashku me vjehërin dhe djalin 8 vjeç, pasi bashkëshorti i saj është emigruar në Greqi. Mëngjesin e djeshëm, teksa ata po prisnin në anë të rrugës të merrnin autobusin, u përplasën nga një automjet tip "Toyota" që po lëvizte me shpejtësi të mad-

he. Fillimisht mjeti është përplasur me barrierën anësore të rrugës dhe më pas goditi tre këmbësorët e u përmbys në rrugë. Për pasojë, Xhemal Fisku dhe nusja e djalit të tij humbën jetën në vend, ndërsa djali 8 vjeç u plagos rëndë dhe u dërgua për mjekim në spitalin e Traumës në Tiranë. Pas aksidentit, policia shoqëroi Ilda Parrojin, e cila ka deklaruar se ajo po ngiste makinën, por nga hetimet e mëtejshme ka rezultuar se autor i aksidentit ishte 40-vjeçari Halil Koka.

HETIMET

Burime për "GSH" dje pohuan se Halil Koka i ka kërkuar të dashurës së tij,

Parrojit të marrë përsipër përgjegjësinë për aksidentin, ndaj edhe 30-vjeçarja fillimisht ka pohuar se ajo po drejtohej "Toyot"-ën që aksidenti me vdekje dy persona. Por, dëshmitë e marra nga policia e Kavajës në vendngjarje ndryshuan rrjedhë. Dëshmitarët kanë deklaruar para bluve se ishte një mashkull, ai që drejtonte makinën. Pas dyshimeve, policia i shoqëroi të dy të rinjtë në komisarit dhe i mori në pyetje për disa orë. Pas ekspertizës nga grupi hetimor dhe marrjes në pyetje në polici, 30-vjeçarja ka ndryshuar dëshminë, ndërsa Halil Koka ka marrë përgjegjësinë e aksidentit.



Asnjë vrasje në 2017-ën në Berat, Veliu: Nuk do të ketë reformë në polici

BERAT - Në qarkun Beratit nuk është shënuar asnjë vrasje gjatë vitit të kaluar. Një fakt i tillë është bërë me dije në analizën e punës njëvjeçare të bluve, ku morën pjesë ministri i Brendshëm, Fatmir Xhafaj dhe drejtori i përgjithshëm i Policisë së Shtetit, Ardi Veliu. Pas aktivitetit, Veliu tha se Drejtoria Vendore e Policisë Berat ka pasur rezultate pozitive. "Vlen për të theksuar që gjatë vitit 2017 në këtë territor nuk është evidentuar asnjë veprë e rëndë penale, pra shifra e ngjarjeve të rënda kriminale është zero. Ashtu si dhe dua të theksoj se numri i aksidenteve me pasojë të rënda, pra me pasojë fatale është jashtëzakonisht i ulët në krahasim me Drejtoritë e tjera Vendore të Policisë. Gjithashtu, gjatë analizës u theksua se gjatë vitit 2018, prioriteti kryesor do të jetë vazhdimi pa ndërprerje i operacionit "Forca e Ligjit" si dhe puna parandaluese, që duhet të bëhet në drejtim të eliminimit të fenomenit të kultivimit të bimëve narkotike. Pyetjes nëse do të ketë reformë në polici, drejtori i policisë iu përgjigj: "Jo, në polici nuk do të ketë reforma. Në polici do të ketë ristrukturim ose riformatim për ta bërë strukturën në mënyrë efektive dhe më fleksibël".

SHPLLALJE ANKANDI

Shoqëria përmbarimore gjyqësore private "ARB" Sh.p.k., zhvillon Ankandin e Tretë për shitjen e pasurisë së paluajtshme Apartament, me sipërfaqe 98.39 m² (nëntëdhjetë e tetë pikë tri dhjetë e nënë metra katrorë), e regjistruar në Zonën Kadastrale Nr. 8603, Regjistruar në Regjistrin Hipotekor Nr. 322, datë 19.11.2004, Numri i Pasurisë 26/121+2-7, Vol. 17, Faqe. 243, me adresë: Lagjia "28 Nëntori", Vlorë, në pronësi të Edlira Allaj, për kredinë e marrë pranë Bankës NBG Albania Sht.a. Çmimi fillestar me të cilin fillon ankandi i tretë është 15,360.00 (pesëmbëdhjetë mijë e treqind e gjashtëdhjetë) Euro. Ankandi do të zhvillohet datë 22.03.2018, ora 16:00, në adresën: Qendra e Zhvillimit të Ankanëve Publike Përmbarimore ("QZHAPP"), me adresë në: Rruga "Nikolla Jorga", Ndërtesa Nr. 9, Kati 2, pranë Dhomës Kombëtare të Përmbaruesve Gjyqësorë Privatë, Tiranë. Secili ofertues duhet të deponojë si garanci në logarinë e ARB me IBAN AL21901110510027173510016018 në EURO pranë Bankës NBG Albania shumën prej 10 % (dhjetë përqind) të çmimit fillestar. Për informacion të mëtejshëm kontaktoni me shoqërinë përmbarimore gjyqësore private "ARB" Sh.p.k., me adresë: Rruga "Fatmir Haxhliu", Pall.: 21, Shk.: 3, Ap.: 3, Tiranë; tel: 042 252888; ose në adresën e email-it: info@arb.al

NJOFTIM SHITJE ME ANKAND

Përmbarimi Gjyqësor Privat "Jon 2014", me përmbaruese Jonida Ulkashi do të zhvillojë Ankandin e dytë për pasurinë "Tsuall", me sipërfaqe 540 m², e regjistruar në ZVRPP Vlorë ZK6604 me nr.pasurie440 vol.13, fq.94 dhe ndërtesa mbi të me sipërfaqe 300 m² e përbërë nga pasuria me nr.4/40-ND/vol.16, fq.105 me sip.150 m² dhe pasuria me nr.4/40-ND/vol.26, fq.106, me sipërfaqe 150 m² e ndodhur në Lagjen "1 Maji", Vlorë. Çmimi me të cilin fillon shitja e kësaj pasurie është në vlerën e 8.345.635 (eta mijë e treqind e dyzet e pesë mijë e gjashtëqind e tridhjetë e pesë) LEK ose 60.480 (gjashtëdhjetë mijë e katërqind e tetëdhjetë) EURO. Ankandi i dytë zhvillohet me datë 19.03.2018, ora 16:00 në ambientet e Zyrisë së përmbaruesve gjyqësorë private Jonida Ulkashi me adresë: Rr. "Myslym Shyri", vll.nr.8/1,4,4, Tiranë.

Shoqëria Përmbarimore "AFA-2010" sh.p.k shpall Ankandin për shitjen e pasurisë së paluajtshme: Pasurisë me Nr. 7/156 e llojit "Tsuall + Ndërtesë", e ndodhur në ZK.2693, Milot, Laç, Kurbin... në pronësi të H.Shabani, Vëns në hipotek për shumën 7,660,000 lekë. Çmimi fillestar në ankand është 5,600,000 Lekë. Ankandi zhvillohet në datë 02.03.2018, ditën e Premte ora 15.30 në ambientet e Shoqërisë Përmbarimore "AFA-2010" sh.p.k në adresën Rruga "Sulejman Delvina", Nd.51, H.9, Ap.1, Tiranë. Për më shumë info: Tel:044503458 ose E-mail: shoqeriapermbarimorreafta2010@gmail.com

ISH-PRONARET KOMPENSIMI

Ish-pronarët që janë kundër vlerësimit financiar që ka vendosur 'Agjencia' mund të ankimojnë

ATP: 1500 dosjet e vitit '97, vlerësimi për çdo pronar

Ornela Manjani

Agjencia e Trajtimt të Pronat ka vlerësim et financiare për ish-pronarët që kanë dorëzuar kërkesën për kompensim në vitin 1997. Agjencia bën të ditur se në përfundim të procesit të verifikimit të vendimeve të administruara pranë arkivës së ATP-së, u identifikuan gjithsej 1462 vendime të vitit 1997, të cilat kanë njohur të drejtën e kompensimit të subjekteve të shpronësuara. Të dhënat lidhur me numrin e vendimit, gjeneralitetet e subjekteve të shpronësuara, sipërfaqja e njohur për kompensim, vlerësimi financiar përkatës apo mangësitë në dokumentacion dhe problematikat në vlerësim jepen të detajuara për çdo dosje. Lista e përditësuar është botuar edhe në Fletoren Zyrtare.

Përfituesit në të gjithë vendin, dokumentet për të marrë paratë

APLIKIMI PËR KOMPENSIM

Pronarët që janë dakord me vlerësimin e ATP-së kanë gjashtë muaj kohë për të plotësuar dokumentet. Përfituesit duhet të dorëzojnë në ATP nëntë dokumente për të marrë 20% të vlerës së pronës në para dhe 80% kompensim fizik. Shifrat janë bërë të ditura nga burime zyrtare pranë Agjencisë së Trajtimt të Pronave, sipas të cilave mësohet se të gjithë pronarët për dosjet e të cilëve është dhënë një vlerësim duhet të paraqiten në 'Agjenci' për të dorëzuar kërkesën për kom-

pensim, konfirmimin nga ZVRPP përkatëse mbi gjendjen juridike të pronës që kompensohet dhe nëse është ushtruar apo jo e drejta e parablerjes (nëse është njohur në vendim); dëshmi trashëgimie, prokurë, deklaratë noteriale e nënshkruar nga subjekti i shpronësuar, vërtetim për numrin e llogarisë bankare, dokument identifikimi dhe mandat pagese. Ndërkohë, pronarët që nuk janë dakord me vlerësimin duhet që brenda 30 ditëve nga data e publikimit të listës të ankimojnë vendimin në Gjykatën Administrative të Apelit.

DOKUMENTET

1. Kërkesë për kompensim.
2. Konfirmimin nga ZVRPP përkatëse mbi gjendjen juridike të pronës që kompensohet dhe nëse është ushtruar apo jo e drejta e parablerjes (nëse është njohur në vendim).
3. Dëshmi trashëgimie nëse ka ndryshuar rrethi i trashëgimtarëve.
4. Prokurë e nënshkruar nga të gjithë trashëgimtarët e ligjshëm, ku si tagër i nevojshëm të jetë dhe e drejta për të tërhequr vlerën financiare në emër të tyre.
5. Deklaratë noteriale të nënshkruar nga subjekti i shpronësuar/përfaqësuesi me prokurë i të gjithë trashëgimtarëve ligjorë të subjektit të shpronësuar, përmes së cilës subjektet vetëdeklarorinë nëse vendimi përfundimtar i kompensimit apo vlerësimi i tij është ankimuar apo jo në rrugë gjyqësore, si dhe nëse këto subjekte kanë qenë apo jo të paditur apo persona të tretë në proceset, për të cilët ata aplikojnë për kompensim, janë kundërshtuar apo jo gjyqësisht nga ana e tyre, si dhe nëse këto subjekte kanë qenë të paditur apo persona të tretë në proceset gjyqësore me objekt ankimin e vendimit për të cilin ata aplikojnë.
6. Deklaratë noteriale të nënshkruar nga subjekti i shpronësuar/përfaqësuesi me prokurë të të gjithë trashëgimtarëve ligjorë të subjektit të shpronësuar, përmes së cilës subjektet vetëdeklarorinë nëse kanë përfutur apo jo nga dispozitat e ligjit për ndarjen e tokës bujqësore.
7. Vërtetim për numrin e llogarisë bankare.
8. Dokument identifikimi.
9. Mandatpagese.

Data/ Dosje	Qarku	Emri (Subjekti Kerkues)	Mbiemri (Subjekti Kerkues)	Sipërfaqja e Njohur/ Mosnjohur	Sipërfaqja e kompensuar	Sip. për kompensim përfundimtar e	VLERESIMI
						Sipërfaqja m2 totale	
01-01-1994	Fier	Edmond Pogaçe		558	558	558.00	
01-01-1997	Gjrokastër	Qani Çibaku		24149	24149	24149.00	339,904
01-01-1997	Gjrokastër	Qani Nuraj		26300	26300	26300.00	372,478
01-01-1997	Gjrokastër	Xhafer Sulo Meçe		200000	200000	200000.00	6,510,255
30-05-1995	Lezhë	Tonin Merdhoqi		11354	11354	11354.00	
01-01-1901	Lezhë	Mark Bibe Doda		13805	13805	13805.00	635,983
25-06-1996	Korçë			5000	5000	5000.00	154,190
01-01-1901	Tiranë	GANI MURATI		11500	11500	11500.00	
28-02-1996	Korçë	Haki Kurili		19000	19000	19000.00	585,923
12-06-1996	Korçë	Nesti Kotmilo		20250	20250	20250.00	747,823
22-02-1996	Korçë	Jorgjia Thimo		18000	18000	18000.00	703,108
08-03-1996	Korçë	Vasilka Çekani		103000	103000	103000.00	4,023,338
22-02-1996	Korçë	Isa Blliri		17150	17150	17150.00	770,855
19-03-1996	Korçë	Ali Hasankolli		28000	28000	28000.00	863,465
07-03-1996	Korçë	Hysen Qerini		28500	28500	28500.00	878,884
28-02-1996	Korçë	Ervehe Laze		15000	15000	15000.00	646,057
06-03-1996	Korçë	Naziko Tefiku		37400	37400	37400.00	1,460,901
13-06-1996	Korçë	Pashako Shufi		13844	13844	13844.00	426,922
07-03-1996	Korçë	Mirash Zeqo		22919	22919	22919.00	324,581
11-03-1996	Korçë	Ali Petritaj		16840	16840	16840.00	411,603
28-06-1996	Korçë	RAKIBE PANE		409	0	0 dhe Parablerie:409	0
28-06-1996	Korçë	Leonidha Mujo		65000	65000	65000.00	3,622,728
25-06-1996	Shkodër	Kol Shiroka		14500	14500	14500.00	533,498
26-06-1996	Shkodër	Tonin Kromiqi		6000	6000	6000.00	185,028
25-06-1996	Shkodër	Zef Loro Kir		23750	23750	23750.00	
25-06-1996	Shkodër	Hasan Radovic		20000	20000	20000.00	959,406
26-06-1996	Shkodër	Veneranda Paliku		20000	20000	20000.00	616,761
25-06-1996	Shkodër	Balkiz Shehi		7500	7500	7500.00	231,285
01-03-1996	Korçë	Gurtali Fezoli		7163	6610	6610.00 dhe Parablerie:553	258,194

Data/ Dosje	Qarku	Emri (Subjekti Kerkues)	Mbiemri (Subjekti Kerkues)	Sipërfaqja e Njohur/ Mosnjohur	Sipërfaqja e kompensuar	Sip. për kompensim përfundimtar e	VLERESIMI
						Sipërfaqja m2 totale	
22-02-1996	Korçë	Ibrahim Brame		16697	16897	16897.00	514,899
07-03-1996	Korçë	Vangjo Nune		76500	76500	76500.00	1,083,443
27-06-1996	Korçë	Mustafi Seit Mekellari		1550	1550	1550.00	
29-02-1996	Korçë	Sotiraj Terova		207000	155700	155700.00	7,508,037
07-03-1996	Korçë	Llazar Burnazi		17200	17200	17200.00	
28-03-1996	Korçë	Violeta Bajraktari		157074	156876	156876.00 dhe Parablerie:198	2,432,814
08-03-1996	Korçë	Shelki Pllati		60400	60400	60400.00	
11-03-1996	Korçë	Ermin Bregu		19600	19600	19600.00	604,426
12-02-1996	Korçë	Hysen Shahinllari		31500	31500	31500.00	971,399
25-06-1996	Shkodër	Trashgimtarët e Jakup Sako Kafi		13000	13000	13000.00	831,485
25-06-1996	Shkodër	Trashgimtarët Elez Can Lahi		3000	3000	3000.00	117,185
10-05-1994	Elbasan	NIGJARE BARDHOSHI (BELS)		100	100	100.00	109,646
21-01-1996	Berat	Nazmi Shahu		840	840	840.00	25,904
21-01-1996	Berat	Nazmi Shahu		39600	39600	39600.00	1,222,329
26-04-1996	Berat	Bahije Tusha		30.7	30100	30100.00	
26-04-1996	Berat	Gëzim Braho		46400	46400	46400.00	1,134,109
29-03-1996	Berat			28000	28000	28000.00	863,465
20-07-1994	Berat	Shkëlqim Musabeliu		22200	22164	22164.00	314,411
20-07-1994	Berat	Shkëlqim Musabeliu		800	800	800.00	584,781
01-01-1996	Korçë			1500	1500	1500.00	71,955
01-01-1997	Korçë	Nihat Sulkollari		4119	3072	3072.00	9,922,182
01-01-1996	Korçë	ALBERT ÇORBAXHIU		12660	12660	12660.00	179,276
01-01-1996	Korçë			9832	9832	9832.00	6,807,671
18-06-1996	Korçë	Pandi Berberi		736	736	736.00	17,989
01-01-1996	Korçë	Gazmend Çorbaxhi		24423	23708	23708.00	-699,553
01-01-1996	Korçë			2915	288	288.00	-2,749,119
20-07-1993	Kukës	Azem Hoxha		26000	26000	26000.00	
20-03-1994	Kukës	Ramazan Muça		17520	17520	17520.00	

SHKODËR - Një 52-vjeçar nga Shkodra është prangosur dy ditë më parë nga policia e Kavajës, pasi i është gjetur në brez një pistoletë tip "Zastava" me silenciator si dhe një krehër me 12 fishekë. Bëhet fjalë për shtetasin Hajrulla Gjekaj, i cili po udhëtonte si pasagjer në automjetin tip "Peugeot" me drejtues 53-vjeçar N.M., banues në Shkodër. Mësohet



Udhëtonte me pistoletë me silenciator në makinë nga Shkodra në Kavajë, arrestohet 52-vjeçari

se Gjekaj u vu në pranga pas një kontrolli rutinë të bluve në autostradën Rrogozhinë-Plepa. Menjëherë, 52-vjeçari është arrestuar për veprën penale "Armëmbajtje pa leje". Ndërsa, mbeten mister rrethanat pse Hajrulla

Gjekaj udhëtoi nga Shkodra në drejtim të Kavajës me armë zjarri me silenciator. Materialet në ngarkim të tij i kaluan Prokurorisë së Rrethit Gjyqësor Kavajë për veprimet të mëtejshme për veprën penale "Prodhimi dhe mbajt-

ja pa leje e armëve luftarakë dhe e municionit". Pritet që gjykata të vendosë masën e sigurisë ndaj shkodrënit. Ndërkohë, policia e Kavajës po heton intensivisht për zbardhjen e plotë të rrethanave të kësaj ngjarjeje.

SHKURT

Abuzimet me rrugën Tiranë-Elbasan, ekspertët kontroll në terren

TIRANË - Pas nisjes së hetimeve për ndërtimin e rrugës Tiranë-Elbasan, prokuroria ka thirrur ekspertët për të inspektuar situatën në terren. Mësohet se tre ekspertë të rrugëve do të shohin nga afër punimet për autostradën Tiranë-Elbasan. Grupi i ekspertëve do të përcaktojë mënyrën real të shkakutuar nga mospërbushja e standardeve për ndërtimin e kësaj rruge. Rezultatet e punës së ekspertëve do të paraqiten si provë ndaj ish-zyrtarëve të Autoritetit Rrugor Shqiptar, të cilët po hetohen për abuzim me fondet e rrugës Tiranë-Elbasan.

Vetëvaret në burg 38-vjeçari i dënuar për vjedhje

FIER - Një i dënuar është vetëvarur në burgun e Fierit. Bëhet fjalë për 38-vjeçarin me inicialet A.M. nga Qeparroi i Vlorës, i dënuar me 3 muaj burg për vjedhje. Mësohet se ai qëndronte i vetëm në qeli, jo me persona të tjerë që mund ta kishin parandaluar aktin ekstrem. "Nga ana e IEVP, Fier, ky person është dërguar për ekzaminim para ngjarjes, pasi ka shfaqur shenja depresive. Ngjarja ka ndodhur rreth orës 22:45 të së premtës, ndërsa i dënuari ndodhej në qeli teke, pa persona të tjerë", bënë me dije burime nga burgu i Fierit. Dyshimet e para janë se 38-vjeçari mund t'i ketë dhënë fund jetës, pasi nuk ka përballuar dot qëndrimin në qeli", thanë burimet nga burgu i Fierit.

Agjenti i shitjeve grabit xhiron ditore dhe largohet

TIRANË - Policia e Tiranës ka shpallur në kërkim një 23-vjeçar, i cili ka grabitur lekët e xhiron ditore në një firmë private. Ngjarja ndodhi dy ditë më parë në rrugën e "Qelqit". Mësohet se autori Xh.B. ishte i punësuar si agjent shitjeve dhe në këtë mënyrë vjedhja e parave dhe largimi i tij ishte shumë i lehtë. Policia po punon për kapjen e tij, por deri më tani ende nuk ka rënë në gjurmët e të riut.

Abuzimi, 8 zyrtarë tjetërsuan e falsifikuan 110.000 m² tokë në Spille

TIRANË

Kryebashkiaku i Rrogozhinës, Beqir Nuredini, i vënë nën akuzë nga prokuroria e Kavajës për tjetërsimin e pronave në bregdetin e Spillës i kërkon prokurorisë të çojë deri në fund hetimet. Dje gjatë protestës së komunitetit çam përpara ambasadës greke, ai deklaroi për "News 24" se akuzat ndaj tij nuk janë sulme politike, ndërsa shtoi se kur të përfundojë hetimi, ai do të dalë i pafajshëm. "Prokuroria të çojë deri në fund hetimin. Nuk e konsideroj një sulm politik, megjithëse unë jam i PDU. Me PS kam bashkëpunuar, por s'ka të bëjë me çështjen në rastin konkret. Kur hetimi të mbyllet, do të jem jashtë çështjes. Pas hetimeve të prokurorisë do dal i pastër", tha Nuredini. Edhe më herët kryebashkiaku i Rrogozhinës është shprehur se është i hapur për çdo hetim. "Duke marrë shkas nga çështjet e ngritura nga prokuroria si kryetar i Bashkisë Rrogozhinë, mbështes hetimet dhe vënie para përgjegjësisë së autorëve. Unë si kryetar bashkie kam zbatuar procedurën që parashikon ligji për përcjelljen e praktikave për regjistrimin fillestar të pronave, të aplikuar nga banorët e zonës. Distancohem nga çdo akuzë që është bërë", pothi Nuredini.

ABUZIMI ME PRONAT

Tjetërsimi i pronave në bregdetin e Spillës pak ditë më parë çoi në arrestimin dhe ndalimin e 8 zyrtarëve publikë. Ndërsa u shpallën në kërkim biznesmeni Ildir Karkini dhe Artur Tosku me detyrë kryeinspektor i Mbrojtjes së Territorit Vendor në Bashkinë e Rrogozhinës. Në hetim është



Kryebashkiaku i Rrogozhinës, Beqir Nuredini

të edhe kreu i Bashkisë së Rrogozhinës, Beqir Nuredini. Të martën, rreth orës 15:00, Drejtoria për Hetimin e Krimit Ekonomik e Financiar, Sektori për Hetimin e Korrupsionit në Departamentin për Hetimin e Krimit të Organizuar dhe Krimet e Rënda në Policinë e Shtetit finalizuan me sukses operacionin policor "Ranishtja 2". Në kuadër të këtij operacioni u arrestuan e ndaluan 8

zyrtarët. Mësohet se në bazë të hetimit proaktiv rreth 1-vjeçar, ka rezultuar se këta zyrtarë në bashkëpunim me njëri-tjetrin, duke abuzuar me detyrën funksionale kanë falsifikuar dhe tjetërsuar rreth 110.000 m² tokë shtetërore ranishte në zonën bregdetare Spille, Kavajë. Mbi bazën e provave të siguruar gjatë hetimit rezultoi se ata kanë përfituar në mënyrë të kund-

draligjshme pasuri të tjetërsuar në bregdet nga "Toka pyje", "Tokë ranishte" dhe "Tokë pa frut", në "Tokë arë". Kjo sipërfaqe ndodhet në vijën bregdetare Spille, Kavajë dhe fshatrat përreth. Për zyrtarët janë ngritur akuzat për veprat penale të "Shpërdorimit të Detyrës", "Falsifikimit të Dokumenteve" dhe "Pastrimit të Produkteve të veprës penale" të kryer në bashkëpunim. Drejtoria për

Hetimin e Krimit Ekonomik e Financiar në Policinë e Shtetit kishte kërkuar me kohë pranë Prokurorisë së Kavajës vendosjen e masës së sigurisë "arrest me burg" për të gjithë të akuzuarit e mëposhtëm. Ndërkaq, prokuroria e Kavajës ka kërkuar pranë Gjykatës së Shkallës së parë Kavajë, masën e sigurisë "Arrest me burg" për zyrtarët e administratës shtetërore.

MASAT E SIGURISË

■ ARREST ME BURG

1. Asim Arkaxhiu, ish-regjistruer i ZVRPP, Kavajë
2. Aldo Kila, jurist pranë ZVRPP, Kavajë
3. Shpendi Dema, jurist, Bashkia Rrogozhinë
4. Arben Daja, sekretar i protokollit, Bashkia Rrogozhinë
5. Artur Tosku, kryeinspektor, specialist i IMTV, Bashkia Rrogozhinë (në kërkim)
6. Ildir Karkini, biznesmen (në kërkim)

■ DETYRIM PARAQITJE

1. Beqir Nuredini, kryetar i Bashkisë Rrogozhinë
2. Arben Kaja, specialist i IMTV, Bashkia Rrogozhinë

■ ARREST SHTËPIE

1. Julian Zhelegu, noter, Dhoma e Noterisë Tiranë

■ PEZULLIM NGA DETYRA

1. Arbër Aliu, noter, Dhoma e Noterisë Durrës

LEZHË - Policia e Lezhës ka vënë në pranga dy persona të akuzuar për një sërë vjedhjesh të ndodhura në Lezhë dhe rrethina, duke mos kursyer dyqane, magazina, servise, makinë, motorë etj. Të paktën 8 vjedhje ka dokumentuar policia ndaj tyre. Pas një pune hetimore të mirorganiuar, blutë bënë të mundur arrestimin e 43-vjeçarit Alket Makaj, banues në Tale-Lezhë. Ai dyshohet si autor i disa vjedhjeve të ndodhura në



Bastisën dyqane, magazina dhe servise, përfundojnë në pranga dy hajdutët

qytetin e Lezhës, të dokumentuara në mënyrë ligjore dhe konkretisht: Më datë 20.01.2018, në rrugën e Spitalit Lezhë, dyshohet se ka vjedhur një motor të mjetit të shtetasit B.L. Më datë 05.02.2018, dyshohet se i ka vjedhur dy bateri të mjetit të shtetasit K.C..

Më datë 22.02.2018, në

lagjen "Besëlidhja", Lezhë, dyshohet se ka vjedhur me thyerje një dyqan kioskë në pronësi të shtetasës D.G..

Më datë 23.02.2018 në lagjen "Besëlidhja" Lezhë, dyshohet se ka vjedhur me thyerje një dyqan kioskë në pronësi të shtetasës R.M.. Gjithashtu, gjatë kontrollit fizik të ushtruar ndaj 43-

vjeçarit në momentin e arrestimit, iu gjetën dhe iu sekuestruan në cilësinë e provës materiale disa doza lëndë e dyshuar narkotike "Marijuanë". I arrestuari tjetër është Rambo Hasani, 27 vjeç, banues në Lezhë. Ai dyshohet si autor i disa vjedhjeve të ndodhura në qytetin e Lezhës dhe

konkretisht: Më datë 23.02.2018, tek magazina në pronësi të shtetasit Xh.S., dyshohet se ka vjedhur disa mjete pune. Më datë 11.02.2018, dyshohet se ka vjedhur servisin në pronësi të shtetasit A.D. në Lezhë. Më datë 16.01.2018 dyshohet se ka vjedhur banesën e shtetasit Gj.Gj. në Ball-dre-Lezhë. Me datë 12.12.2017, dyshohet se ka vjedhur magazinën në pronësi të shtetasit N.M. në Rrilë.

E DIEL
25 Shkurt
2018

MILOSA



“KANGA E MILETIT” ose himni i vërtetë shqiptar

NGA PROF.
GAZMEND SHPUZA

Edhe një herë për himnin e Lidhjes së Prizrenit

*Dhe një kujtesë për organet shtetërore në Tiranë dhe në Prishtinë
si dhe për organizmat kulturore në mbarë botën shqiptare*

Para katër vjetësh pata shkruar për këtë temë. Megjithatë, ende pak kush e din në se ka ekzistuar një himn i Lidhjes së Prizrenit, cili është ai, kush janë autorët e tij dhe ca më pak njihet historia e ekzekutimit të tij me pengime të tejskashme gjatë këtyre afro 140 viteve që nga koha e krijimit. Është harruar, ka mbetur pothuajse i panjohur. E pabesueshme!

Hymni lindi në vitet e lavdishme 1878-1881. Megjithëse as katër vjet, ato -përfaqësojnë, pa e tepruar, një periudhë epokale të his-

torisë sonë kombëtare në rrafsh ideor, politik, organizativ përbashkues në mbrojtje të tërësisë së trojeve amtare dhe të luftës për sigurimin e Shqipërisë autonome. Pikërisht në ato vite lindi dhe Marshi i Lidhjes “Bashkimi i Shqipnisë”.

Burime të para 130 e sa vjetëve japin dëshmi të sakta dhe tejet interesante lidhur me Hymnin e parë Kombëtar të shqiptarëve, pak të njohur edhe në mjediset tona muzikore. Sapo u shkrua teksti, u kompozua dhe ekzekutua me bandë edhe u këndua nga

luftëtarët që po niseshin në front për mbrojtjen e trojeve amtare. Vlen të theksohet, se ekzekutimi i Hymnit pati jehonë, në shtypin evropian të kohës sapo u vu në qarkullim.

Të dhënat e para për të i kumtonte studiuesi Mikel Prenushi, në prag të 100-vjetorit të Lidhjes së Prizrenit. Shkrimi i tij nuk pati aso kohe jehonën që i takonte. Gjithësesi ndikoi për përfshirjen e Hymnit në repertorin e Bandës muzikore të atëherëshme të Ushtrisë Popullore, e cila e ekzekutoi atë midis marsheve atdhetare në sheshin që mban emrin e Heroit Kombëtar, para monu-

mentit, të tij, me rastin e jubileut madhështor të 100-vjetorit të Lidhjes.

Nismën për krijimin e bandës e pat ndërmarrë arbëreshi At Tomaseo Markoci (Marcozzi). I mirënjohuri aso kohe në Shkodër, Patër Toma me ndihmat e mbledhura në Pazar, qendra e atëherëshme ekonomike e qytetit më të madh të Shqipërisë, porosi ti dhe solli nga Italia instrumentet muzikore për bandë dhe pajtoi për ngritjen e orkestrës frymore mjeshtrin napolitan Gjon Kanale (Giovanni Canale) edhe ky arbëresh. Koncertin e parë

në publik banda e Shkodrës e dha me rastin e Krishtlindjeve të vitit 1878. Banda me një formacion prej 31 instrumentistësh, që në fillimet e veprimtarisë së saj, jepte koncerte here pas here dhe më pas çdo të djelë dhe për festa të mëdha fetare. Ajo administrohej nga kleri katolik. Populli e quante atë “Daullja”.

Korrespondenti i gazetës austriake “Wiener Allgemeinen Zeitung”, i ndodhur në Shkodër, më 1880 dëshmon: “Zoti Canale...kishte fituar merita të mëdha me anën e krijimit të një bande muzikore qytetse. Brenda një kohe të shkurtër, nga sh-

qiptarë të pamësuar, që nuk kishin asnjë ide për muzikën, përgatiti muzikantë të shkëlqyer. Unë u mahnitua nga puna e bandës muzikore që luante me një saktësi të rrallë. Patjetër u preka në mënyrë të veçantë kur në rastin e së kremen të Korpit të Krishtit në katedrale, degjova arie operash në vend të këngëve kishtarë... Në fund ajo dha me sukses “Marshin e Lidhjes” kompozuar nga vete zoti Canale. Me duhet të rrëfej se bukuria e tij që krejtësisht e papritur”.



Vijon në faqen 14

Në këtë numër: Prof. Kristo Frashëri, Prof. Gazmend Shpuza, Leonard Zissi, Ndue Dedaj për Musine Kokalarin, Leka Ndoja, etj...

D

DOKUMENT

Himni i Lidhjes "Bashkimi i Shqipnisë" mbetet në fakt Himni i Shqiptarisë një himn i kompozuar nga padre Gjon Kanale, arbëresh i lindur dhe i formuar në atmosferën e revolucionit çlirimtar italian nga i cili lindi Italia e bashkuar. Si tekst ka shërbyer finalja e poezisë kushtrim "O moj Shqypni" shkruar ato ditë nga Pashko Vasa, pjesëmarrës aktiv i revolucionit italian, ideologu i madh i Rilindjes Kombëtare Shqiptare. Ai Himn përshkohet tejendatë nga fryma europiane aktuale dhe sot e kësaj dite. Himnin e Shqiptarisë emigrantët tanë e kanë ekzekutuar, sipas prof. Dhimiter S. Shuteriqit, edhe nën tingujt e muzikës së kompozitorit rus Rimskij Korsakov...

“KANGA E MILETIT” EDHE NJË HERË PËR HIMNIN E LIDHJES SË PRIZRENIT

*Dhe një kujtesë për organet shtetërore në Tiranë dhe në Prishtinë
si dhe për organizmat kulturore në mbarë botën shqiptare*

NGA PROF. GAZMEND SHPUZA

Vijon nga faqja 13

Korespondenti vjenez një hës i kulturuar i muzikës europiane, na dokumenton aso kohe veprimtarinë artistike, jo vetëm fetare por dhe laike dhe, mbi të gjitha, atdhetare, të bandës qytetëse të Shkodrës. Injohur nga afër me këtë eveniment kulturor jo të zakonshëm ai e vlerëson lart atë: "Jam i bindur se ky marsh po të botohej, shpejt do të qarkullonte në Evropë, siç ngjet shpesh me ndonjë pjesë të bukur që të kënaq veshin." Hymni i kompozuar nga Patër Gjon Kanale vlerësohej në përjasje me ato që ekzekutoheshin aso kohe në Evropë, madje, në një nivel të pëlqyeshëm.

Më pas, repertori i orkestrës frymore do të përfshinte, veç muzikës kishtarë dhe pjesë të vogla: marshe, këngë atdhetare, përpunime këngësh popullore në formën e potpurive etj. Ajo u pasurua, gjithashtu, dhe me pjesë të zgjedhura nga repertori operistik. Orkestra frymore bëhet gjithnjë e më shumë pjesëmarrëse aktive në jetën shoqërore dhe politike të kohës.

Teksti i Marshit të Lidhjes u bë i njohur në Shkodër në prill-maj 1880 përmes fletëve volante të shtypura në Stamboll. Në to qe riprodhuar poema-kushtrim e Pashko Vasës "O moj Shqypni". Ajo u bë shpejt e dashur për luftëtarët dhe popullin tonë. Sipas një dokumenti të atyre ditëve, dëshmohej, se "Kanga i jep shpirt popullit". Jemi në një kohë kur qëndresa e shqiptarëve, siç deklarohet në mbrojtje të trojeve evropiane.

Siç shprehë një dokumenti vendosur i vitit 1880, lëvizjes politiko-kulturore shqiptare të viteve të Lidhjes, jepte "gajret (kurajo) vegjelia", njëheriz e thjeshtë, që po luftonin me heroizem në mbrojtje të trojeve amtare.

Marshi Kombëtar i shqiptarëve i viteve shtatëdhjetë të shekullit XIX i hartuar nga luftëtarët i revolucionit për çlirim të Italisë nga zgjedha austro-hungare, Pashko Vasë Shkodrani, dhe i kompozuar nga mjeshtri napolitan Xhovani Kanale është plotësisht evropian jo vetëm në aspektin e gjuhës muzikore, por dhe nga përmbajtja kombëtare e demokratike. Pikërisht për këtë arsye ai nuk u ekzekutua dhe as nuk u këndua haptazi pas shtypjes së Lidhjes së Prizrenit. Por dhe pas Shpalljes së Pavarësisë ekzekutimi i tij nuk qe aq fatlum.

Prof. Injac Zamputi flet për qëndrimin që është mbajtur, sikurse ndaj veprave të tjera të rilindasit tonë të madh, edhe ndaj Hymnit të Lidhjes nga frika se mos mbillej "fara e keqe e antiklerikalizmit dhe e antidespotizmit" në popull. "Ne jemi dëshmitarë, shkruan ish-nxënësi i dalluar i kolegjit Saverian të Shkodrës e më pas profesori i këtij institucioni arsimor, se e kemi kënd-

uar përherë me mall e zjarr këngën e Pashko Vasës, dhe e këndonim fund e majë, por askurrë nuk na i kishin thënë ato fjalë që flasin për "kisha e xhamija" për "priftërinj e hoxhallarë", për "fenë e shqiptarit që është shqiptaria". Këto elemente i kemi ndeshur shumë më vonë, në moshën e pjekurisë, në literaturë". Pra, në kohën e rinisë së tij Hymni këndohej i cenzuruar, pa vargjet lapidare «Mos shikoni kisha e xhamia, feja e shqiptarit është shqiptaria».

Gjithësesi, të paktën, muzika e Hymnit "Bashkimi i Shqipnisë" jehoi fuqishëm para 35 vjetësh në 100-vjetorin e Lidhjes së Prizrenit. Kurse në 100-vjetorin e shpalljes së Pavarësisë Hymni i Lidhjes nuk u dëgjua të këndohej vetëm u interpretua nga orkestra e TOB-it brenda katër mureve të sallës së tij. Madje, muzika e saj aty nuk u shoqërua, të paktën, me recitim mjeshteror të vargjeve të Pashko Vasës prej artistëve të mirënjohur Reshat Arbana nga Tirana apo Mirush Kabashi nga Gjakova, të cilët qenë të pranishëm në ato vite në mjaft koncerte të dhëna në trojet shqiptare dhe në diasporë.

Vlera e Pashko Vasës të madh nuk u zbeh në kohën kur pretendohet se u teprua me recitim të vargjeve "Feja e Shqiptarit është Shqiptaria" edhe nga vetë krerët e partisë shtet. Vlerat e tij të vërteta u zbehën, jopak, vetëm atëhere kur himni i tij u censurova dhe sidomos kur nuk u dëgjua fare. edhe i recituar rrallë.

Ky qëndrim ndaj Hymnit të Lidhjes po mbahet edhe sot kur veprat e tij madhore atdhetare, shkencore dhe letrare prijete lihen në harrësë. Për këtë po ndikon për keq jo më pak se dikur interpretimi fundamentalist nga të gjitha krahet e vargjeve të tij papidare: "Mos shikoni kisha e xhamia, kisha e shqiptarit është shqiptaria!" Kisha e xhamia në trajtimin artistik të Pashkos katolik nuk stigmatizoheshin si institucione fetare në vetvete por si vende ku qenë grumbulluar në shumicë klerikë të huaj apo dhe vendas, të cilët duke mos u kufizuar me shërbesat fetare, qenë rreshtuar në shërbim të politikave antishqiptare. Priftërnjtë dhe hoxhallarët e sotëm në trevat shqiptare nuk kanë pse të identifikohen me shumicën e



Banda frymore e drejtuar nga Palok Kurti

klerikëve që kanë shërbyer në to gjatës Rilindjes dhe më heret.

Gazetarit libanez Mubarak, i cili pati ndihmuar, siç dëshmon diplomati i atëhershëm Delan Buxheli në Egjipt, ambasadën tonë për atd-hesimin e eshterave të Pashko Vasë nga Libani në Shkodër i pat bërë shumë përshtypje sesi ndodhte që

Marshi kombëtar

Marshi kombëtar i shqiptarëve i viteve shtatëdhjetë të shekullit XIX, i hartuar nga luftëtarët i revolucionit për çlirim të Italisë nga zgjedha austro-hungare, Pashko Vasë Shkodrani, dhe i kompozuar nga mjeshtri napolitan Xhovani Kanale është plotësisht evropian jo vetëm në aspektin e gjuhës muzikore, por dhe nga përmbajtja kombëtare e demokratike. Pikërisht për këtë arsye ai nuk u ekzekutua dhe as nuk u këndua haptazi pas shtypjes së Lidhjes së Prizrenit. Por dhe pas shpalljes së pavarësisë ekzekutimi i tij nuk qe aq fatlum.

që nuk ka gjuhën, as gjakun tuej! Qani ju shpata, qani dyfeqe, se u zhqypni, por si zog nder leqet! Coniu, o shqyptare, prej gjumit çoniu, të gjithë si vilazan ne nje bese shtrëngoniu, edhe mos shikoni kisha e xhamia, fe e Shqyptarit është Shqyptaria. Cysh prej Tivarit deri ne Preveze gjithkund leshon dielli vap' e rreze, ashte tota jone, te paret na e kane lan, kush mos na e prek, se desim, t'lane. Te desim si burrat qe diqne moit, e te mos marroha perpara Zotit."

Për autorin e tekstit të hymnit "O moj Shqypni" Shqiptaria ishte Kombi i Muslimanëve, i Orthodoxëve dhe i Katolikëve Shqiptarë, të konsideruar nga politikant teokratike ballkanike, prapa të cilave qëndronin ato europiane, turq, helenë dhe latine. Nga popujt neolatinë, katolikë, asnjë nuk vetëhiritet sot e kësaj dite "latin". Të tillë ata quheshin, me sa dimë, në kuadër të sistemit osman të "miletëve". Grekët vetëhiriteshin rumë e të krishterë. Epirotë asnjëherë nuk u shkoi mendja ta qanin veten, aq më pak vorioepirotë; nuk bëhej fjalë që ta ulnin veten, prapa të sa ta vinin në një shkallë me fqinjët e tyre që i qanin barbarë.

Edhe turqit deri në fillim të shekullit XX, duke apeluar në besimin e tyre vetëqusheshin, së bashku me arabët e të tjerë, duke mohuar kombësinë e tyre. Përballë këtyre realiteteve myslimanët tanë, në masë, e qanin veten shqiptarë. Pati dhe prej tyre, kur ballkanasit dhe edhe evropianët i qanin turq, të mbërthyer në grackën e propagandave teokratike, u vetëquajtën turq, gjithëherë në kuptimin thjesht fetar. Aso kohe vetë turqit nuk vetëqusheshin etnikisht ashtu siç u takonte, por vetëm myslimanë.

Gjithësesi, myslimanët shqiptarë nuk e ngatërruan asnjëherë veten me turqit në rrafsh etnik. Për ta nuk qe i panjohur fakti që intelektualë osmanë të kombësisë turke, deri në fillim të shekullit XX, emërtimin e tyre etnik turk e përdornin me përbuzje për të shënjuar fshatarët e Andollit.

Vargjet e Pashko Vasës "Feja e shqiptarit është shqiptaria..." ishin përgjithësim i një realiteti gjeografar të ngulitur prej shekujsh në truallin shqiptar. Ato ishin rrjedhim

A

ARGUMENT


NGA KRISTO FRASHËRI*

Vijon nga numri i shkruar

Kontributi i dytë që ai dha në intervistën e fundit, është gjithashtu i çuditshëm. Vetë Oliveri thotë se gjesti i Skënderbeut duke kapur për gjoksi komandantin e kështjellës së Tranit, Giovanni Antonio de Foxa, tregoka karakterin e Skënderbeut se e urren tradhtinë. Ai vetë shkruan se ky gjest, i cili i ngjan "dy burrave që zihen për grykë", tregon karakterin e Skënderbeut. Pyesim: a mjafton ky gjest për të provuar se Skënderbeu e urren tradhtinë? Ky qenka një nga zbulimet e mëdha që paska arritur historiani zviceran? Ai ka harruar se Skënderbeu nuk është një Vilhelm Tel që fiton lavdi duke iu bindur mbretit të qëllorë me shigjetë një mollë mbi kokën e djalit të vet, por një kreshnik që ballafaqohet me dhjetëra herë në fushën e betejave, me ushtritë osmane shumë herë më superiore se ushtritë shqiptare. Veç kësaj, përse na e shet këtë episod sikur ai e ka zbuluar për herë të parë? Për më tepër, ai mbështetet vetëm në letërnë diplomatit milanez, të cilin e lexon mbrapsht (nuk është Skënderbeu që i propozon mbretit Ferrant, siç thotë O. J. Schmitt-i, që ta hiqte qafe G. A. De Foxa-n, por e kundërta, është mbreti Ferrant, siç shkruhet në letërnë diplomatit milanez, ai që i kërkon Skënderbeut ta hiqte atë qafe). Veç kësaj, në monografinë e përmendur të Kr. Frashërit mbi Skënderbeun janë dhënë jo një, por tre burime të ndryshme për këtë episod (ff. 285-386). Më në fund, gjesti i Skënderbeut nuk tregon, siç thotë O. Schmitt-i, urretjen e tij ndaj tradhtisë, mbasi në këtë rast ai zbatonte porosinë e mbretit Ferrant. Qëndrimin ndaj tradhtisë Skënderbeu e ka treguar jo në qytetin Trani të Pulies (Itali) ku zbatonte porosinë e mbretit Ferrant, por në Shqipëri ku ishte vetë "Zot" dhe ku nuk i ndëshkoi bashkëpunëtorët e tij kur e tradhtuan.

Kjo linjë nuk i ka pëlqyer historianit të ri zviceran Oliver Jens Schmitt. Ai me një të rënë të lapsit e ka dënuar me vdekje historiografinë shqiptare skënderbegiane jo vetëm të viteve të regjimit komunist, por edhe të periudhës parakomuniste. Përse? Sipas tij, çdo pikëpamje mbi ngjarjet historike të së kaluarës e shprehur gjatë regjimit komunist është prodhim i Enver Hoxhës ose prodhim që i shkpton për shtat regjimit komunist. Meqenësve figura e Skënderbeut ashtu siç e ka trajtuar historiografia shqiptare gjatë viteve të regjimit komunist i pas-

Kjo është pjesë e shtesës që në të gjallë akademiku Kristo Frashëri përgatiti për monografinë e tij me titull "Skënderbeu, jeta dhe vepra". Në këtë shtojcë gjendet edhe kritika e tij ndaj disa pikëpamjeve thelbësore të shfaqura nga autori zviceran, Oliver Jens Schmitt në monografinë e tij me titull "Skënderbeu" (2008)..



ka shërbyer diktaturës enveriste, kjo historiografi dhe ky Skënderbe, sipas O. J. Schmitt-it, duhet flakur tej. Sikurse shihet, historiografinë shqiptare skënderbegiane O. J. Schmitt-i e dënon si një historiografi dogmatike, vetëm se i paska shërbyer regjimit komunist. Historiani zviceran nuk sheh se me argumentin që sjell se ajo historiografi duhet dënuar vetëm se i ka shërbyer regjimit komunist dhe jo se është në vetvete e pasaktë, tregon se ai nuk i ka parë rrënjët e vërteta të ideologjisë nacional-komuniste, me të cilën ai e damkos të ashtuquajturën diktaturë të proletariatit të periudhës së E. Hoxhës. Historianët që kanë ndjekur nga afër zhvillimin e ngjarjeve politike dhe ideologjike të Shqipërisë, nuk e kanë vështirë të kuptojnë bashkëjetesën e ideologjisë komuniste të Karl Marksit dhe ideologjinë nacionaliste të rilindësve shqiptarë të bashkëngjiturë në të ashtuquajturën ideologji të demokracisë popullore. Ata nuk e kanë vësh-

vitin 1967 kur filloi fushata, edhe për ne e egër dhe absurde, kundër institucioneve fetare të të gjitha riteve pa dallim. Sipas tij, vlerësimi i Skënderbeut në këtë kohë nga E. Hoxha u shty nga nevojja që kishte Partia e Punës për të zëvendësuar fetë që komunizmi po i luftonte me doktrina dhe me institucione me një fe të re, me një qendër figurën e Skënderbeut. Ai pohon: "Më 1968 u bë një kongres i madh shkencor dhe filluan përpjekjet që kulti i Skënderbeut të futet si një religjon zëvendësues. Pra, feja ndalohej dhe fillon ateizmi, por njerëzve u duhej dhënë diçka zëvendësuese". Për këtë arsye, pohon ai, Skënderbeu u prapagandua edhe nga historiografia shqiptare "si figura qendrore e një feje civile komuniste". Natyrisht është e tepruar të thuhet se kjo ishte, sipas tij, pika kulmore e figurës së Skënderbeut. Ai u pa si paraardhësi i Enver Hoxhës dhe u përdor një pamje shumë ideologjike e figurës së tij (Gazeta "Albania", e shtunë, 24 janar 2009,

Pse Schmitt e hedh poshtë historiografinë shqiptare?!

tirë të kuptojnë se Enver Hoxha me ardhjen në pushtet ishte i detyruar të përgjërohej, si për njëherë ashtu dhe për tjetër, duke mos u shqepurur nga asnjëra prej tyre. Madje, duke u mbështetur sipas rrethanave historike më tepër herë të njëra ideologji, herë të tjetra. Kur Shqipëria u pranua në Traktatin e Varshavës më 1955, E. Hoxha mbasi siguroi mbështetjen e bllokut socialist ndërkombëtar, nga synimet që kishte me qëllim të përfundimit të mbështetjes në forcat e brendshme, e ndjeu veten më të lirë për të zbatuar politikën nacionale rilindëse. Prishja e marrëdhënieve politike me kampin socialist, e bëri më të domosdoshëm mbështetjen te forcat nacionale politike të brendshme. Tek ky zgjim i politikës nacionale shpjegohen krensimet e bujshme që ndërmoi qeveria e E. Hoxhës në vitet '60-'70 siç ishin krensimi i 50-vjetorit të shpalljes së pavarësisë (28 Nëntor 1962); përkujtimi ndërkombëtar i jashtëzakonshëm i 500-vjetorit të vdekjes së Skënderbeut më 17 janar 1968; krensimi i 100-vjetorit të Lidhjes Shqiptare të Prizrenit (10 qershor 1978) dhe i temave të tjera të historisë kombëtare të Shqipërisë. Rëndësi të veçantë pati përkujtimi i 500-vjetorit të vdekjes së Skënderbeut. Kjo për arsye se 500-vjetori i vdekjes së Heroit ishte një rast i mirëpritur për të nënvizuar karakterin nacional të jetës së Shqipërisë, edhe në situatën e trazuar kur Shqipëria për të siguruar pavarësinë jetonte midis shtetësismeve të theksuara. Çështja nacionale ishte për Sh-

qipërinë një çështje jetike. Për realizimin e saj, forcat politike shqiptare nuk mund të qëndronin spektatore vetëm duke u mbështetur të doktrina marksiste. Në fakt, jo vetëm forcat demokratike shqiptare të djathta e të majta, por edhe dashamirësit e Shqipërisë të shpërndarë në mbarë botën, e ndjen për detyrë të jepnin kontributin e tyre në çështjen kombëtare shqiptare. Është e padrejtë që të gjithë dashamirësit e pavarësisë së Shqipërisë të periudhës së Rilindjes, të cilësohen të doktrinuar si komunistë, për arsye se E. Hoxha shpalsi edhe ai flamurin e Pavarësisë Kombëtare.

Mirëpo, historiani zviceran përpigjet të hedhë në kosh edhe historiografinë shqiptare skënderbegiane parakomuniste, e cila, sipas

Për Enver Hoxhën

Kur Shqipëria u pranua në Traktatin e Varshavës më 1955, E. Hoxha mbasi siguroi mbështetjen e bllokut socialist ndërkombëtar, nga synimet që kishte me qëllim të përfundimit të mbështetjes në forcat e brendshme, e ndjeu veten më të lirë për të zbatuar politikën nacionale rilindëse. Prishja e marrëdhënieve politike me kampin socialist, e bëri më të domosdoshëm mbështetjen te forcat nacionale politike të brendshme. Tek ky zgjim i politikës nacionale shpjegohen krensimet e bujshme që ndërmoi qeveria e E. Hoxhës në vitet '60-'70.

tij, ka ndjekur pak a shumë të njëjtin linjë. Kjo tregon se nuk është fjala te regjimi komunist, por te vetë Skënderbeu. Dëshmi është fakti se urretja ndaj Skënderbeut e ka shtyrë historianin zviceran të fshijë nga Pasqyra e Bibliografisë të trajtesës së tij disa nga veprat e historiografisë skënderbegiane shqiptare të botuara jo vetëm gjatë regjimit komunist, por edhe para se të vendosej diktatura. Përse nuk e ka përmendur disertacionin e Xhevat Korçës, botuar më 1923? Përse nuk i ka vënë në dukje meritat e disertacionit të Athanas Gegajt, botuar më 1937? Përse merret me Fan Nolin e vitit 1921 dhe jo me Fan Nolin e vitit 1947, i cili, sikurse u tha, e ka korigjuar vetë punimin e tij të vitit 1921? Përse në Pasqyrën e Bibliografisë së trajtesës së tij nuk e sheh gjëkund emrin e Aleks Budës?

Megjithatë, midis historianëve shqiptarë të periudhës komuniste breshërinë më të madhe O. Schmitt-i e drejtoi kundër prof. Aleks Budës. Kjo për arsye se ai u bë më 1973 kryetari i Akademisë së Shkencave të Shqipërisë. Argumentet që sjell historiani zviceran janë vërtet të habitshme. Sipas tij, prof. Aleks Buda, i cili dihet se nuk ka bërë pjesë asnjëherë në strukturat udhëheqëse të Partisë Komuniste, madje nuk ka qenë as anëtar i thjeshtë i PKSh-së apo i PPSH-së, i paska shërbyer më tepër se kushdo Enver Hoxhës në synimet e diktatorit për t'u bërë vetë mit i historisë së Shqipërisë. Historiani zviceran ka pet pas ngjarjeve që ndodhën në

f. 21).

Në të njëjtën kohë, historiani zviceran pranon se midis figurës së Skënderbeut dhe diktatorit Enver Hoxha ka një ndryshim të madh. Ndryshimin, të cilin ai nuk e thotë, po ia themi ne. Skënderbeu udhëhoqte politikisht një vend të hapur, kurse Enver Hoxha një vend të izoluar. Skënderbeu u orientua nga Perëndimi, Enver Hoxha nga Lindja. Skënderbeu ishte fetar. E. Hoxha ateist. Skënderbeu ishte tolerant, Enver Hoxha ishte despot. Skënderbeu nuk dënoi njeri me vdekje, Enver Hoxha kosariti mjaft koka kundërshtarësh. Pyesim: në këto rrethana, si mundej Skënderbeu t'i shërbente diktaturës së E. Hoxhës? Si mundej Enver Hoxha ta kthente veprën e Skënderbeut në një fe në shërbim të diktaturës komuniste? Si mundej që E. Hoxha të bëhej një Skënderbe i ri?

Në suazën e këtij "zbulimi" imagjinari që ka sjellë truri i fantaksur i O. Schmitt-it është vendosur dhe Aleks Buda. Për të provuar saktësinë e zbulimit të tij historiani zviceran sjell si shembull një fragment nga një shkrim i Aleks Budës, në të cilin ne prisim që kryetari "mekatar" i Akademisë së Shkencave të Shqipërisë t'i thurte hosana Enver Hoxhës. Në të vërtetë, ai nuk e zë fare në gojë E. Hoxhën. Në fragmentin që O. Schmitt ka nxjerrë nga shkrimi i Aleks Budës me titull "Fan Noli dhe Skënderbeu", thuhet:

"Pas luftës së madhe antifashiste, ku pjesëmarrja e masave popullore luajti një rol kaq të madh në asgjësimin e pushtuesve, figu-

B BOTIM

NGA LEONARD ZISSI*

Në muajin dhjetor të vitit 2017, në Varshavë doli botimi i librit monografik të autorit Arqile Teta me titull "Profesor Stanislav Zuber - Jeta dhe vepra". Ky libër u përkthye në polonisht nga përkthyesja e njohur polake Dorota Horodyska dhe u botua nga Shtëpia Botuese "Poza Krajem", nën kujdesin dhe mbështetjen e Ministrisë së Kulturës dhe Trashëgimisë Kombëtare të Polonisë.

Nafta në sasi jo industriale për herë të parë u zbulua 100 vjet më parë në Drashovicë të Vlorës, nga gjeologët italianë dhe rezultoi që nëntoka shqiptare, në gjirin e saj, fshihet rezervat hidrokarburesh. Filluan kështu kërkimet e etshme dhe për 10 vjet u shpuan disa qindra puse kërkimi, por naftë për shfrytëzim industrial nuk po zbulohej.

Kur shoqëritë italiane të hidrokarbureve pikasën talentin e madh në kërkimin e naftës, gjeologun polak Stanislav Zuber dhe i krijuan të gjitha kushtet për kërkimin e saj në Shqipëri, në vitin 1928, në Kuçovë, ai shpoi pusin e parë që dha naftë dhe kështu filloi periudha e nxjerrjes industriale të naftës nga nëntoka shqiptare. Për këtë, me të drejtë Zuberi është quajtur themeluesi i kërkimit, zbulimit dhe shfrytëzimit të naftës në Shqipëri. Ai hozi bazat e krijimit të sektorit të industrisë së naftës në vendin tonë, një degë kjo nga më të rëndësishmet e ekonomisë shqiptare edhe në ditët e sotme. Pas Kuçovës u zbulua dhe u fuqizua kantjeri tjetër i naftës, ai i Patosit, i cili u zgjerua dhe u shtri nga Lushnja e deri në Fimig të Sarandës.

Me zbulimet e vendburimeve të naftës në vendin tonë, Zuber-i tërhoqi vëmendjen e gjithë Europës. Në vitet '30 të shekullit të kaluar, Shqipëria u quajt "Mesopotamia e Re" nga Shoqata e Gjeologëve Italianë dhe e profesorëve gjeologë të huaj që u mbledhën në Kuçovë në Kongresin "Convegno", ku i thurrën kuro-ra lavde Zuber-it, ndërmjet tyre edhe gjeologu italian L.Maddalena që kishte shpuar pusin në Drashovicë në vitin 1918.

Profesor Stanislav Zuber la një trashëgimi të gjërë e të larishtme hartash gjeologjike, ku spikat kryevepra e tij, Harta Tektonike e Shqipërisë në shkallën 1:400 000, si dhe shumë studime, vrojtime, relacione për mineralet e kromit, bakrit, hekur-nikelit, etj., të cilët pasqyrohen në botimin polonisht të librit për Profesor Stanislav Zuber-in.

Botimi në polonisht i këtij libri, është i rëndësishëm dhe shumë dimensional për qarqet shkencore polake dhe në përgjithësi për opinion publik polak.

Profesor Stanislav Zuber i përket një plejade të tërë gjeologësh të shquar polakë që kanë dhënë dhe vazhdojnë të japin kontributin e tyre në fushën e gjeologjisë dhe minierave në shumë vende të ndryshme të Botës. Ai është pjestar i familjes së shquar Zuber, mjaft e njohur në mjedisin polak. I jati i tij, Rudolf Zuber (1858-1920), ka qënë një gjeolog i nivelit botëror, që ka zbuluar vendburime të naftës në Rusi, Trinidad, Venezuelë, Meksikë, Guine, Argjentinë, Kanada, Shtet

Libri botohet në kuadër të 100 -vjetorit të zbulimit të naftës në Shqipëri. Në muajin dhjetor të vitit 2017, në Varshavë doli botimi i librit monografik të autorit Arqile Teta me titull "Profesor Stanislav Zuber - Jeta dhe vepra". Ky libër u përkthye në polonisht nga përkthyesja e njohur polake Dorota Horodyska dhe u botua nga Shtëpia Botuese "Poza Krajem", nën kujdesin dhe mbështetjen e Ministrisë së Kulturës dhe Trashëgimisë Kombëtare të Polonisë...

Libri për profesor Stanislav Zuber i autorit Arqile Teta botohet polonisht





STANISLLAV ZUBER

tet e Bashkuara të Amerikës dhe në Indinë Lindore. Edhe vëllai më i vogël i Stanislavit, Kazimir Zuber, ka qënë inxhinier shpim pusesh i zoti që ka punuar në vende të ndryshme, duke përfshirë edhe Shqipërinë, i dërguar nga firma italiane që bënin kërkime të vendburimeve të naftës në vendin tonë. Në Poloni, familja Zuber gëzon një poullaritet të madh edhe për shkak të zbulimit prej saj të vendburimit të ujit mineral në qendrën kurative Krynica Zdroj, nga ku, që nga viti 1935 e deri sot prodhohet uji mineral i ambalazhuar në shishe me etiketë "Zuber".

Botimi i këtij libri në polonisht i jep mundësinë lexuesit polak të njihet me jetën dhe veprimtarinë e Zuberit në Shqipëri në fushën e gjeologjisë, me arrestimin e tij nga rregjimi komunist i asaj kohe, me vdekjen tragjike të tij në burgun e Titanës, si edhe me rehabilitimin e figurës së Zuberit pas rrëzimit të regjimit komunist në vendin tonë.

Interesim të veçantë për këtë libër kanë tërëgjar qarqet shkencore të Universitetit Jagjellon i Krakovit (UJ) dhe Akademisë së Minierave dhe Metalurgjisë (AGH) po të Krakovit. Zuberi është i njohur në këto qarqe për veprimtarinë në përgjithësi të tij në Shqipëri në fushën e gjeologjisë së naftës, por jo për veprimtarinë konkrete të tij në zbulimin dhe shfrytëzimin e burimeve naftëmbajtëse, si dhe për kontributin në zbulimin e mineraleve të ndryshëm që mban nëntoka shqiptare. Ekspozate të këtyre mineraleve Zuber-i i pat ekspozuar në Muzeun Gjeologjik që ngrihti në Kuçovë në vitin 1946, i cili ishte nga Muzetë më të mirët në Ballkë, por që fatkeqësisht u shkatërrua nga rregjimi komunist pas arrestimit të tij. Nëpërmjet këtij libri, lexuesi polak mund të njihet edhe me korespondencën e Zuberit jo vetëm me familjen e tij, por edhe me qarqet akademike të Universitetit Jagjellon të Krakovit dhe të Akademisë së Minierave dhe Metalurgjisë, me kërkesat dhe propozimet që iu ka paraqitur atyre.

Një kapitull i veçantë që paraqet interes për lexuesin polak, është edhe periudha e ar-



restimit dhe vdekjes tragjike të Zuber-it në burgun e Tiranës në vitin 1947. Dëshmitari i kësaj ngjarjeje ka qënë shkrimtari i njohur Petro Marko, i cili në castin e vdekjes së Zuber-it ka vuajtur në të njëjtën qeli me të. Më vonë, pas rrëzimit të diktaturës komuniste, mbresat dhe kujtimet nga kjo ngjarje tragjike, ai i botoi në gazetën "Bashkimi" të datës 14 prill 1991, në një artikull me ndjenja revolutese, me titull "Krim kundër kulturës Universale".

Ky artikull sensibilizoi Sho-

qatën e Miqësisë Shqipëri-Poloni, e cila që nga ky cast u bë iniciatori dhe promotorja e një sërë veprimtarive që çuan në rehabilitimin e plotë të figurës dhe kontributit të shquar të Profesor Stanislav Zuber-it në fushën e gjeologjisë në përgjithësi në Shqipëri. Për Profesor Stanislav Zuber-in u organizuan dy konferenca shkencore, në vitin 1992 dhe 1993, në të cilat u realizua rehabilitimi zyrtar i plotë i figurës dhe veprës së tij. Ai është dekoruar me Medaljen "Martir i Demokracisë" nga Presidenti Sali Berisha më 17.10.1992 dhe me Urdhërin "Nënë Tereza" nga Presidenti Bamir Topi më 13.10.2011. Këshilli Bashkiak i Kuçovës i ka dhënë Profesor Stanislav Zuber-it titullin "Qytetar Nderi" më 14.10.1993 dhe një nga rrugët kryesore të qytetit mban emrin e tij. E rëndësishme është edhe monografia e Profesor Arqile Tetës për Jetën dhe Veprën e Profesor Stanislav Zuber-it, që është objekt i këtij materiali. Momenti më kryesor i rehabilitimit të Profesor Stanislav Zuber-it padyshim që është vendosja në qendër të qytetit të Kuçovës i bustit të tij që u inaugurua më 13.10.2011 nga Presidenti i Republikës Bamir Topi dhe Ministri i Kulturës dhe Trashëgimisë Kombëtare i Polonisë Bogdan Zdrojewski. Së fundi, me iniciativën e Ambasadës së Polonisë në Tiranë dhe me mbështetjen e saj, në vitin 2017, në fasadën e burgut të Tiranës pranë basorellievit kushtuar të burgosurve politikë që u torturuan në atë burg nga diktatura komuniste, u vendos edhe basorellievi i Profesor Zuber-it.

Siç është rehabilituar figura e Profesor Stanislav Zuber-it, nuk është rehabilituar asnjë figurë tjetër e shquar e huaj që ka kontribuar në zhvillimin ekonomik dhe kulturor të vendit tonë. Kjo është shprehje edhe e ndjesës morale të popullit shqiptar për popullin polak, për vdekjen tragjike të këtij shkencëtari të madh nga diktatura komuniste në Shqipëri.

Organizimi i këtyre veprimtarive për rehabilitimin e figurës së Profesor Stanislav Zuber-it me iniciativën e Shoqatës së Miqësisë Shqipëri-Poloni, u bë i mundur me angazhimin e plotë të institucioneve më të rëndësishme shqiptare, duke filluar nga Presidencia e Republikës, Këshilli Bashkiak i Tiranës dhe Kuçovës, të Universitetit Politeknik të Tiranës dhe Fakultetit të Gjeologjisë dhe Minierave të këtij Universiteti. Një ndihmesë të çmuar dhanë profesorët më të shquar të fushës së gjeologjisë shqiptare, të cilët, me referatet dhe kumtesat e tyre me një nivel të lartë shkencor, mbajtën në Konferencat shkencore në vitet 1992 dhe 1993, zbuluan fytyrën e ndritur prej shkencëtari të Profesor Stanislav Zuber-it. Nga ana polake duhen falenderuar me pëzëmersi angazhimin dhe kontributin e veçantë të organizimit e këtyre veprimtarive i Ambasadës së Polonisë në Tiranë, i Ministrisë së Kulturës dhe

Trashëgimisë Kombëtare të Polonisë dhe i Senatit Polak.

Libri në versionin polonisht për Zuber-in është botuar me cilësi të lartë dhe në fund të tij është shtuar edhe një "Pashënie" që tregon ceremoninë e inaugurimit të bustit të Zuberit në Kuçovë më 13.10.2011. Po ashtu ai është pasuruar me fotografi me peisazhe të bukura nga malet shqiptare, duke bërë në këtë mënyrë edhe një promovim të turizmit në Shqipëri.

Literatura artistike shqiptare është përkthyer në shumë gjuhë të huaja, por ndoshta libri për Profesor Stanislav Zuber-in është i vetmi që një botim shqiptar, jo vetëm me karakter letrar artistik, por që i kushtohet figurës së një shkencëtari të shquar të huaj, përkthehet dhe botohet në vendin e këtij personalliteti.

Botimi në polonisht i librit për Profesor Stanislav Zuber-in, është edhe një sukses për autorin e tij, Profesor Arqile Tetën. Ndonjësi është i diplomuar për gjeologji dhe miniera, Profesor Teta ka dhënë dhe vazhdon të japë një kontribut të veçantë në fushën e përhapjes së kulturës polake në Shqipëri. Ai ka lëvruar fushat e përkthimit të literaturës polake në gjuhën shqipe dhe në atë të krijimtariisë letrare për problematike e marrëdhënieve shqiptaropolake dhe për figura të shquara të dala nga gjiri i popullit polak, siç është në këtë rast figura e Profesor Stanislav Zuber-it. Profesor Teta është autor i shumë artikujve botuar në shtypin tonë për këto tematika që janë pika takimi në historinë e të dy popujve tanë. Ka përkthyer literaturën polake në gjuhën shqipe dhe së shpejti, në kuadrin e 550 vjetorit të Heroit tonë Kombëtar Gjergj Kasasriti Skënderbeut, del nga shtypi vepra e historiani dhe iluministit polak Marcin Bielski, shkruar për Skënderbeun në shekullin XVI.

Përveç librit për Profesor Stanislav Zuber-in, vepra më e rëndësishme në fushën e krijimtariisë e Profesor Tetës, është Fjalori Polonisht-Shqip, botuar në vitin 2007 dhe së shpejti do të dalë nga botimi edhe Fjalori Shqip-Polonisht.

Për këtë veprimtari në përhapjen e kulturës polake në vendin tonë, Profesor Arqile Teta është dekoruar nga Presidenti i Polonisë me dekoratën e lartë "Kryqi i Kavalerit të Urdhërit për Merita ndaj Republikës së Polonisë".

Polonia është një nga shtetet ku është shkruar gjerësisht për historinë dhe kulturën e popullit tonë. Duke filluar nga shekulli XVI e deri sot, numurohen rreth 3500 botime të ndryshme, si libra, monografi, studime dhe artikuj të ndryshëm kushtuar popullit shqiptar. Sot në Shqipëri përkthehet ndjeshëm literatura polake, në sajë të dashamirësive dhe njohëse të gjuhës dhe kulturës polake. Një prej tyre është edhe Profesor Arqile Teta.

*Kryetar Nderi i Shoqatës së Miqësisë Shqipëri-Poloni Tiranë, 26.01.2018

Opinioni / Ditës

Pse e majta shqiptare nuk qeveris dot si e majtë?!

Nga Ben Andoni

(vijen nga faqja 1)

... e dukshme në një drejtim, që ky Ekzekutiv ka vetëdije më të larta sa i përket administrimit të shtetit dhe krijimit të strukturave, që e mundësojnë funksionimin. Anipse në realitet qeveria e majtë e zotit Rama nuk po i gjegjëjt realisht nevojës së qytetarit të thjeshtë shqiptar. Për më tepër cinizmi i të gjithë administratës së tij ndaj problematikës së klasës së varfër dhe asaj të mesme është i dukshëm. Fillimisht, sa i përket përgjigjes ndaj përbushjes së detyrimeve dhe së dyti, përshtatjes së programit me nevojat e njerëzve. Klima ekonomiko-sociale në peizazhin zhvillimor të vendit është e zymtë, kurse e vetmja shpresë për fasha të ndryshme të shoqërisë po mbetet largimi.

E majta e dy mandatave të fundit, jo shumë larg asaj të së shkuarës, mëton se po drejton brenda kanoneve të së majtës, por nga mënyra e realizimit të funksionit të saj është një forcë krejt e djathtë, jo pak herë krahasuar disi me të djathtën ekstreme. Në ditët tona, shumë segmente të funksionimit të fushave të ndryshme të ekonomisë së vendit janë dhënë me koncesion, mirëfilli politikë e djathtë, fakt që e mbart fuqinë tek privatit. Referimet për pakorrektesinë e tyre po denoncohen vazhdimisht dhe koncesionet janë kthyer në simbol të pafunksionimit. Për më tepër, koncesionet, me gjithë mëtimet se do të sillnin ndryshime, duhet thënë se aty ku janë aplikuar jo vetëm nuk kanë dhënë rezultatet e duhura, por e kanë keqësuar shërbimin ndaj publikut dhe e kanë zbehur pritshmërinë e të ashtuquajturit Partneritet Publik-Privat.

Buxheti i qeverisë së majtë, në këtë mandat ashtu si dihet dhe thuhet nga propaganda e saj e justifikim marrjen e taksave me argumentin e rritjes së investimeve publike. Thelbi i tyre në një model funksional ekonomie është rritja e ekonomisë së vendit, punësimi dhe mbi të gjitha, rritja e konsumit. Në fakt, konsumi po tkurret edhe nga referencat zyrtare, punësimi lë shumë për të dëshiruar. Të gjitha këto jo vetëm nuk po funksionojnë si duhet dhe nuk referohet pse dëshirojnë, por përmes retorikave dhe justifikimeve po mëtohet sërish për rritje të mëtejshme taksash, për të cilat priten zgjidhjet e sloganeve programore të "Rilindjes Urbane".

Dhe, njësoj si me të djathtën, edhe nën qeverisjen e majtë të Ramës, Partneriteti Publik-Privat po favorizon bizneset në kurriz të qytetarit, kurse nga ana e tyre parlamentarët shqiptarë thjesht apro-



vojnë duke ligjëruar interesa biznesi në dëm real të pasurive dhe interesave publike. Dhe keqardhja shtohet kur kujton se megjithëse në fushat elektorale u pretendua për kontroll të kontratave koncesionare, asgjë e re nuk ndodhi. "Për të mos thënë se situata është përkeqësuar nga 'negocimi' jotransparent i tyre, që më e pakta kanë ruajtur interesat, përndryshe fitimet, e kompanive që i kanë fituar; në tavolinat e restoranteve ku bëhen bisedime të tilla dhe pak ose aspak në jetën ekonomike të vendit apo në 'tregun e lirë', siç thuhet ndryshe", shprehet analisti ekonomik Zef Preçi në një koment të tijin. Një listë e gjatë koncesionesh, e cila fillon me nxjerrjen e përpunimin e naftës, aeroportin ndërkombëtar të vendit, ngjyrosjen e karburanteve, sterilizimin e përgendruar të instrumenteve, vendim-parkimet, dëgjen me incinerator, mbikëqyrjen e lojërave të fatit, e deri te aeroporti i Vlorës kanë një të përbashkët: u mungon elementi bazë që quhet transparencë, por edhe demoi që po krijojnë në kurriz të ekonomisë. Pikërisht këtë dëm,

që shkon kinse i pavërejtur, qeveria e majtë e neutralizon në dukje duke shtuar lakun e taksave të klasat e varfra dhe të mesme për të shprehur politikën e veta.

E majta shqiptare, e përsërisim, është gjithnjë e më shumë cinike, sepse nuk është më transparente. Ndërkohë që një e majtë efektive dhe në artikulum duhet të jetë shumë më e afruar me njerëzit. Por të mjafton të shikosh ligjërimet e kryeministrit dhe e vartësve të tij, bindesh se e majta ka probleme të mëdha në konceptimin e vetvetes. Dhe, më shumë akoma, të mjafton të shikosh luksin e përfaqësuesve të saj, ata që e përfaqësojnë dhe retorikat e saj, që të bëjnë të trishtosh. Përveç opozitës, ajo nuk kursen në fyerje me median dhe këdo komunitet interes, që i preken atributet bazë. Ka një të vërtetë në atë që thotë kryeministri sa i përket nënvlefësisht të punës, porse shqiptari po e humb pak nga pak dhe atë pak nerv punë prej vetë politikës kaotike të majtë. Që gjithsesi nuk mund të justifikohet me cinizmin e pafre që po bëhet ndaj njerëzve. Kësaj i shtohet kaosi i pensioneve, kontributit që mezi

verifikohen (në rastin më të mirë), shërbimet e dobëta, mungesa e investimeve të huaja, mungesa e punës dhe mbi të gjitha, vrasja e shpresës që nuk mund të përbëjë asesi një politikë të majtë.

Partitë e majta mbështeten zakonisht fort nga punëtorët si dhe nga shtresa e mesme, kurse partitë e djathta, nga të ashtuquajturit kapitalistë dhe punëdhënësit, e paqka relativitetit të këtij konstataimi, e majta shqiptare është më afër interesave të të fortëve sesa përfaqësuesve të klasave të varfra, që përballen çdo ditë me mbi-jetesën. Këtë e shikon nga përbërja e saj, por edhe politika në ndihmë të vazhdueshme e të pakushtëzuar ndaj të kamurve të dyshimtë. E nuk mbaron këtu. E majta shqiptare, përfaqësuar më së shumti dhe pothuaj vetëm nga PS-ja në fuqi (LSI nuk po e llogarisim, sepse nuk mundi asnjëherë të përçojë si duhet ideologjinë e saj) e ka haruar elektoratin e saj, ashtu si harroi simbolikat klasike, sepse fatkeqësisht ka humbur dhe po humb çdo ditë identitetin e saj si parti e majtë.

"Gazeta Shqiptare"

HOROSKOPI

DASHI

E diel në shtëpi, harroni sportet ekstreme dhe jetën e dalldisur. Pas një jave të lodhshme, nuk keni dëshirë të bëni asgjë. Familja ju përkëdhel dhe ju mbështet, por siç ju ndodh shpesh, nuk do arrini të çlodheni sa duhet.

DEMI

Udhëtim në fshat për të vizituar një të afërmin tuaj. Do shijoni çdo gjë, ngjyrat, aromat, ushqimet e gatuar dhe pasionin tuaj. Të gatshëm të ndihmoni një mikun tuaj. Sensi juaj praktik është një ndihmë e madhe për të.

BINJAKET

Në kontrast me botën që shpëton nga objektet e padobishme dhe anti-ke, ju shkonti t'i kërkonti në tregjet e gjërave të vjetra dhe të përdorura. Loja e blerjes sot ka shijen e kompensimit, ndoshta mbush boshllëkun e lënë nga dikush tjetër.

GAFORJA

E diel e shkëlqyer për t'u kaluar mundësisht afër ujit, elementi juaj. Deti dhe liqeni shkëlqejnë dhe mprehin ndjeshmërinë tuaj. Intuita e jashtëzakonshme ju ndihmon të kuptoni menjëherë diçka që ka kohë që ju shpëton.

LUANI

E diel pa ledhatime dhe ngjarje, asgjë shqetësuese, por as emocionuese. Ndjeheni mirë në ambientin tuaj, pa ndërhyrjen e të tjerëve. Aktivitetet dhe vizitat surprizë sot nuk janë në stili tuaj, gjë që do ta tregoni në mënyrë të qartë.

VIRGJERESHA

Intoleranca sot duhet të frenohet me reduktimin e ushqimeve alergjike në kuzhinë. Edhe në restorant mos u tundoni nga ushqime jo të shëndetshme. Humor të mirë, por keni tendencën e fortë të dyshoni për çdo gjë. Prezenca e miqve të këndshëm ju jep një lloj sigurie.

PESHORJA

Vihuni në lëvizje për të kundërshtuar një ditë pak melankolike, pa u përfshirë shumë nga kujtimet dhe keqardhja për gjërat e humbura. Të punoni të dielen nuk është një problem për ju, madje bëhet një kënaqësi, nëse ambienti ju bën të ndjeheni të domosdoshëm.

AKREPI

E diel, çlodhje totale, por mos e interpretoni fjalën si pushim absolut. Çlodhja e sotme do të thotë ekskurSION në natyrë, ose vizitë në një qytet arti. Gjë e bukur ta ndani entuziazmin dhe emocionet me personat që keni afër.

SHIGJETARI

Është e domosdoshme që sot të merreni me punët e shtëpisë. Kaosi i krijuar nuk ju lejon të gjeni dokumente të vlefshme dhe gjëra të shpërdara. Asnjë sforcim tjetër nuk është i mirëpritur. Rrëmuja që keni në shtëpi nuk kursen as mendjen dhe zemrën.

BRICJAPI

Të shqetësuar për faj të Hënës, që nga shenja e kundërt ngacmon emocionet dhe kujtimet, në kundërshtim me vetëkontrollin tuaj të famshëm. Pak fjalë, por shumë ëndrra në shtet. Partneri është gati t'i ndajë ëndrrat, por ju akoma jo.

UJORI

Ndryshe nga të tjerët, të dielën keni dëshirë ta kaloni duke punuar. Në pritje të shpenzimeve të rëndësishme, do hiqni dorë nga çlodhja dhe argëtimi. Pak entuziazëm në çift, asnjë të re për ata që janë single.

PESHQIT

Të zhytur në ëndrra romantike, ndoshta në një plazh larg, më tërë të bardhë, palma dhe aroma ekzotike. Por ndoshta realiteti nuk është kaq emocionues... Nëse keni partner, do jetë ai që do ju udhëqej. Nëse jeni vetëm, ndjenja e boshllëkut është e padurueshme.

Opinion i Ditës

95 vjet nga themelimi i Komunitetit Mysliman të Shqipërisë

Nga Genti Kruja

(vijon nga faqja 1)

... dhe bashkëjetesa etnike dhe fetare, që janë ndër normat themelore të etikës dhe moralit të një populli ishin pjesë e identitetit mbarëkombëtar dhe sot janë nga vlerat me të cilat ne vazhdojmë të krenohemi në sytë e botës.

140 vjet më parë dijetarë dhe prijës të tillë si Daut efendi Borçiq, H. Ymer Prizreni, së bashku me bashkëkombësit e tyre të besimeve të tjera do të mbanin kuvendin e famshëm të Lidhjes së Prizrenit në xhaminë Bajrakli dhe Medresenë e Mehmet Pashës, që sot njihet si muzeu i Lidhjes së Prizrenit.

Më pas, shpallja e pavarësisë i gjeti përsëri udhëheqësit fetarë në krye të momenteve historike të vendit tonë, të cilët ishin pikërisht këta prijës, të cilët do të unifikonin institucionet islame në trojet shqiptare nëpërmjet zhvillimit të disa kongreseve kombëtare.

Kështu, Komuniteti Mysliman i Shqipërisë u themelua nga rilindësi dhe firmëtarë të pavarësisë 95 vjet më parë, si një bashkësi që do të përfaqësonte zërin e besimtarëve myslimanë në Shqipëri, trojet shqiptare, madje, në mjaft raste edhe zërin e mbarë shqiptarëve.

Kuptohet që ky institucion është vazhdimësia e institucioneve islame, që ekzistojnë prej shekujsh në vendin tonë nëpërmjet myftinive, gjyqve të shariatit me kadinjtë e famshëm, medreseve dhe mejetëve, të shtrirra pothuajse në çdo hapësirë shqiptare. Pas shpalljes së pavarësisë, kryetari i parë i Kuvendit do të ishte H. Vehbi Dibra, i cili dha edhe fjetvanë për flamurin shqiptar. Më pas ai do të emërohej si Myfti i Përgjithshëm dhe pas disa vitesh në këtë detyrë, H. Vehbi Dibra e dijetarë të tjerë shqiptarë thirrën Kongresin e Parë Mysliman Shqiptar plot 95 vite më parë për të ngritur institucionin më të lartë islam shqiptar, duke u quajtur Komuniteti Mysliman Shqiptar nga Gjyqi i Naltë i Sheriatit, që quhej nga 1916. Ky kongres i filloi punimet më 24 shkurt deri më 12 mars 1923 dhe që historik për nga vendimet që mori. Ai i zhvilloi punimet në Tiranë, në sallën e shoqërisë "Djelmnia Di-brane", kryetar i së cilës ishte patrioti Dervish Hima. Në Kongres merrnin pjesë 36 delegatë, shtatë prej tyre ishin deputetë.

H. Vehbi Dibra, i cili u zgjodh edhe kryetari i parë i Komunitetit Mysliman Shqiptar theksoi përpara të gjithë delegatëve rëndësinë e vëllazërimit kombëtar të të gjithë shqiptarëve. "Sikurse e dini zotëria e juaj, popullsia e Shtetit tonë përbahej prej tre elementesh d.m.th. mysliman, katolik dhe ortodoks, po në pikëpamje të kombësisë në mes tonë kemi një vllazni të plotë e të patundshme, e



nuk mund të thuhet e të kuptohet asnjë send që e tund atë vllaznie të plotë. Çështja e fesë është një çështje e posaçme e sejcili është i lirë për me e sigurizim forcimin e fesë së vet. Ky organizim i fesë sonë është vendosur qysh në Kongres të Dibrës fatzeq, po luftat ballkanike e ndaluen këtë qëllim".

Në vitet e para të formimit të vet, Komuniteti Mysliman ishte jo vetëm promovues i edukatës dhe moralit të lartë shoqëror, por edhe pararojë e një institucioni të mirëorganizuar, që përbente një model për institucionet e tjera shtetërore e më gjerë, që natyrshëm kishin shumë nevojë për modele të mira.

Një hap shumë i rëndësishëm i Komunitetit Mysliman të Shqipërisë ishte unifikimi i medreseve më 1924, e cila në fillim u quajt "Medreseja e Naltë", e hapur në Tiranë kryeqytet, për të qenë në të ardhmen dhe një shkollë e lartë, e cila më vonë do të quhej "Medreseja e Përgjithshme", nga bankat e së cilës do të dilnin personalitetet të tilla si, akademik Shaban Demiraj, e qindra personalitete të tjera, që do të jepnin një kontribut të jashtëzakonshëm në arsimin shqiptar e në vitet '90 si promotor të rihapjes së institucioneve fetare dhe medreseve në të katër anët e vendit. Ajo çka e bëri të veçantë medresenë e Tiranës, nga shumica e simotrave të saj në botë në atë kohë, ishte koncepti i mësimdhënies në to. Komuniteti Mysliman gërshetoi në Medrese së bashku me lëndët fetare edhe ato shkencore dhe bëri përpjekjet maksimale, që profilin dhe nivelin arsimor në të ta mbante në standardet më të larta të kohës, çka e bëri atë një ndër shkollat më të mira asokohe, por edhe sot.

Një tjetër fushë e rëndësishme ku Komuniteti Mysliman i Shqipërisë dha një kontribut të

pazëvendësueshëm është edhe ajo e botimeve të shumë librave dhe revistave, si "Zani i Naltë" (në dy periudha 1923-1939 dhe 2012 e në vazhdim dhe sot), "Kultura Islame" (1939-1945), "Njeriu" (1942-1944), "Drita Islame" (1992, e cila vazhdon dhe sot), etj.

Historia e viteve që pasuan, e sidomos ajo pas Luftës së Dytë Botërore me fillimin e regjimit komunist do të ishte shumë e ashpër me besimin dhe besimtarët, sikundër ndodhte edhe me të gjithë shqiptarët. Vuajtjet u bënë pjesë e jetës së komunitetit më të madh në vend për më shumë se gjysmë shekulli, sepse më shumë se çdo kusht tjetër dhe mbi çdo torturë fizike, besimtarëve iu mohua përkujtimi i Zotit, iu ndalua besimi, iu ndrydh ndërjegjia, iu ndërpre komunikimi, që ata kishin me Krijuesin e tyre, Zotin e gjithësisë.

Megjithatë, ishte trashëgimia shpirtërore e këtij populli, që zbuti shturjen totale të shoqërisë sonë prej furtunës komuniste dhe shumë besimtarë e ruajtën identitetin e tyre, duke kryer edhe një pjesë të riteve fshehurazi.

Regjimi komunisto-ateist, që u vendos në Shqipëri në vitin 1944, filloi një dhunë të egër ndaj fesë, duke persekutuar prijësit fetarë, por edhe njerëzit e thjeshtë. Më 1967 Shqipëria u shpall vendi i parë ateist në botë, duke shkatërruar shumicën e kishave, xhamive dhe teqeve. Nga 1127 xhami që ishin në 1967, në 1990 kishin mbetur vetëm disa, të shndërruara dhe përcudnuara në depo, magazina, apo të braktisura dhe të rrënuara.

Figurat më përfaqësuese publike të myslimanëve shqiptarë u dënuan nga gjyqet komuniste, ndërsa shumë të tjerë ndërruan jetë nëpër burgje dhe kampe internimi.

Rihapja e aktivitetit fetar islam

me standarde ndërkombëtare synon tërheqjen dhe arsimimin e të rinjve jo vetëm nga Shqipëria, por edhe nga vendet e rajonit, Evropa dhe bota, duke u kthyer kështu në një qendër të promovimit të vlerave universale.

Universiteti ofron programe studimore të ciklit të parë dhe të dytë në fushat e shkencave humane, si dhe të filologjisë, me qëllim parësor kualifikimin akademik të studentëve. Ai ka dy fakultete, Fakultetin e Shkencave Humane, si dhe Fakultetin e Filologjisë dhe të Edukimit. E veçanta e këtij universiteti është Departamenti i Shkencave Islame, i cili tashmë përgatit kuadrot e Komunitetit Mysliman në vendin tonë, pa pasur nevojë të shkollohen jashtë vendi.

Aktualisht në medrese studiojnë mbi 2.000 nxënës dhe rreth 850 studentë në Universitetin "Bedër". Staf akademik i universitetit vjen nga 12 shtete të ndryshme, ndërsa studentët nga 18 shtete.

KMSH sot mbart një barrë të jashtëzakonshme në një kohë sfidash të mëdha institucionale. Problemi më i madh mbetet moskthimi i pronave të shtetëzuara nga regjimi komunist, gjë e cila për vite të tëra ka sjellë vartësi ekonomike nga shoqata dhe fondacione të ndryshme. Shteti akoma është indiferent ndaj këtij procesi sa delikat aq edhe jetik për institucionin.

Një tjetër problematikë prej pesë vitesh mbetet dhe mosnjohja e diplomave të huaja në fushën e teologjisë islame, për të cilën aktualisht po negociohet për ofrimin e asistencës akademike nëpërmjet Universitetit "Bedër".

Komuniteti Mysliman i Shqipërisë sot ka një rol të rëndësishëm institucional në ruajtjen e paqes dhe stabilitetit social, edukativ, moral dhe të bashkëjetesës ndër-fetare. Janë këto arsye, që shpesh e kanë bërë këtë institucion të jetë në qendër të vëmendjes në momente kyçe dhe historike për rolin që mbart, por madje në disa raste ky rol dhe kjo peshë kaq qenë edhe sfiduese.


Tranzicioni i këtij institucioni ka qenë mjaft i vështirë, sepse vitet '90 e gjetën të zëruar në çdo aspekt, duke qenë se regjimi komunist i kishte dhënë një goditje fatale. Aspekti kombëtar në traditën e këtij institucioni ishte sfida më e madhe, që ia vështirësoi ringritjen, duke qenë se historikisht prijësit fetarë të tij kanë qenë dhe janë shqiptarë historikisht. Mirëpo plejada e ndritur e prijësve myslimanë ishte shuar prej kohësh dhe kjo solli jo pak sfida ndër vite për Komunitetin Mysliman.

Sot sfidat janë nga më të ndryshmet, por një KMSH e konsoliduar në të gjitha aspektet është një garanci më shumë për një zë të rëndësishëm dhe kontribuues në shoqërinë shqiptare.

Kështu, KMSH ka në mbarëvajtje dhe ndjekje institucionale gjashtë medrese në gjashtë qytete të ndryshme si Tiranë, Elbasan, Korçë, Shkodër, Kavajë dhe Durrës për djem dhe vajza të ciklit 9-vjeçar dhe të mesëm, si dhe Universitetin "Bedër", themeluar më 2011 me vendim të Kryesisë së KMSH-së.

Universiteti "Bedër", i pajisur

Fjalëkryqi (1)



HORIZONTAL

- Miller e Verdi-t.
- Më e mira është rekord.
- Inicialet e Derain.
- Kishte 100 Teba.
- Është vija e portës
- Në fund te rritjes.
- Drejtori Lokale Përmet.
- Inicialet e Seagal.
- King Cole i muzikes.
- Ishte shpendi simbol i Jezu Krishtit.
- Artikull spanjol.
- Janë fjalëpakë.
- Fillojnë titrat.
- Është i mërzitshmi.
- Ashtu si jeton heremit.
- U kompozua nga Ravel.
- Janë spanjollët dhe portugezët.
- Një kitarë indiane.

- Janë edhe ato të sigurimit.
- Është e harlisur në xhungël.
- Mbyllin fushatat.
- Kështu thirrje Eisenhower.
- Ai dhe ajo.
- Fillojnë vallon.
- Inicialet e Delon.
- Kalohet në gjumë.
- Martini që që këngëtare
- Një thirrje me emra.

VERTIKAL

- U quajt qyteti atomik.
- Qyteti i Abrahamit.
- Italia në tabela.
- Sapo fillojnë.
- Nemo ai i Nautilus.
- Janë në botë
- Një tabu islamike
- I famshmi Pacino.
- Janë si falimentime
- Ngjyhet një në tavolocë.
- Timo i Mato Grudës.
- Janë borxhlinj.
- E përditshmja që ke në dorë.
- Carson i fumetti-t.
- U shkrua nga Sartre.
- Në fund të vitit.
- Është lloj poezie.
- Janë shtëpi... qeni.
- Janë kapriçiot.
- Verifikuar pjesërisht.
- Kërcimi i Fred Astaire.
- Është sekrete në derë.
- Kodi i celularit.
- Daja i Amerikës.
- Kaluar në krye.
- Fillojnë detyrën.

Fjalëkryqi (2)


HORIZONTAL

- Atkinson, alias Mister Bean.
- Ishte dyqanxhi i dikurshëm.
- Ferrara regjisor.
- Kalohet në gjumë.
- Të parat në sondazh.
- Është nofka.
- Një treshe në skenë.
- Nuk i tregohen babait.
- Gjysmë tatimi.
- Berenger aktor.
- Në mes të një forme.
- Bëjnë stili të lirë
- Fillojnë nazet
- Kalimi në kufij.
- Një tragjedi... e Dreiser.
- Grier aktore.
- Dashi kur mungon ai
- Është zanore në filma
- Kufizohet në kufij
- Ente Civile Europiane.


VERTIKAL

VERTIKAL


- Është edhe ajo emërore.
- Është edhe ai mbretëror.
- Të parat në Wellington
- Një vegël
- Është vendi aderues
- Është emirat.
- Mbyllin portat.
- Pak latinisht.
- Janë zjarrvënës.
- Qyteti i perjestshëm.
- Kufizojnë rastet.
- Shkroi Këngëtarja tullce.
- Inicialet e Moravia-s.
- Janë trille.
- Qytet italian.
- Jepen për hartim.
- Fillojë takimet.
- Kufizojnë kënde.
- Janë vendet e para.
- Një greminë.
- Është illogarin që qërohet.
- Ndigen me ilaçe.
- Massari aktore italiane.
- Janë kapot.
- Numri i oktetit.
- Kush ka... fërgëllon.
- Një i fundit mbi të gjithë.
- Një pjesë e satelitëve.
- Fillojnë tjetrën.
- Derisa janë në fund.
- Inicialet e Taylor aktore.



Gjeni ndryshimin



Dy figurat kanë ndryshime nga njëra-tjetra



Përgjigja, ja cilat janë ndryshimet e figurave

SUDOKU

	3	4		9		6			
9			8		7				1
		5				7			
		9	6	4	3	8			
	1							2	
		8	9	1	2	3			
		4				6			
8			2		4				7
	5		3		1			4	

Përgjigje e sudokut të numrit të kaluar

3	4	5	9	1	8	2	7	6
8	9	2	7	5	6	4	3	1
7	1	6	4	2	3	9	5	8
6	5	3	2	9	1	8	4	7
4	2	7	8	6	5	3	1	9
9	8	1	3	4	7	5	6	2
5	3	8	1	7	9	6	2	4
1	6	4	5	8	2	7	9	3
2	7	9	6	3	4	1	8	5

Plotësoni vendet bosh në mënyrë që çdo kolonë të ketë numrat nga 1-9


Argëtim filozofik

- Ata që nuk kërkojnë asgjë edhe vetë nuk japin asgjë. **{Gille}**
- Disa njerëz japin premtime për hir të kënaqësisë që kanë kur nuk i mbajnë ato. **{Hezlit}**
- Sikundër nuk ka peshk pa hala, nuk ka edhe njeri pa të meta. **{Luter}**
- "Çdo dalje është një hyrje diku." **Tom Stoppard**
- Mendojnë për të ardhmen me shqetësim, dhe harrojnë të tashmen, nuk e jetojnë të tashmen e as të ardhmen, (i humbin të dyja).

KRIPTOSKEME

KRIPTOSKEME

Përgjigja e numrit të djeshëm



PËRGJIGJET E FJALËKRYQJEVE TË NUMRIT TË KALUAR

FJALËKRYQI (1)

FJALËKRYQI (2)



Ëhënie të mënçura

- Njerëzit e mirë janë gjithmonë të parët...
- qe zhgënjehen... sepse venë shpirtin në çdo gjë që bëjnë... por kurrë nuk duhet të përfitosh nga durimi i tyre... sepse janë të fundit që lodhen... por dhe të parët që nuk kthehen prapa...
- Fol vetëm atëherë, kur ajo farë ke për të thënë është më e bukur se heshja...
- Miku më i madh i së vërtetës është koha, më i madh armik i saj është paragjykimi, ndërsa shoqërujesja e përhershme është përlësia.

Koltoni

www.gsh.al

www.gsh.al

www.gsh.al

www.gsh.al

www.gsh.al

www.gsh.al

GAZETA SHQIPTARE

GSH.AL

- Na merrni!
- Na shkruani!
- Na lexoni!

GSH

www.gsh.al

Tashmë edhe lundroni!

